



الإسلام في ألبانيا
إدارة العلاقات العامة بالمسجد الحرام
اللغة الألبانية

Pajisja e Agjëruesit



Autor:
Fehd ibën Jahja El-Ammarij

Përshtati në shqip, **Bledar Ali**







Pajisja e Agjëruesit

Autor:
Fehd ibën Jahja El-Ammarij

Përshtati në shqip, **Bledar Ali**



Parathënie



Gjithë falënderimet dhe lavdërimet janë vetëm për Allahun. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi atë pas të cilit nuk ka profet tjetër.

Nga mirësitë më të mëdha me të cilat Allahu i begatoi robërit e Tij pas të dërguarve dhe profetëve, është prezenca e dijetarëve, trashëgimtarëve të profetëve: Udhërrëfyesit, yjet rrezatues dhe meteorët ndriçues e dritëlëshues.

Allahu i njeh ata, përkrahësit e mesazhit të Tij,

Por edhe njerëzit i njohin si ndihmëtarë të së vërtetës.

Nga arsyet që lumturojnë zemrën, zgjerojnë kraharonin dhe që forcojnë dëshirat e zjarrta dhe shpresën (me gjithë fuqinë e mjeteve të rrënimit dhe luftën e hapur kundër Islamit), janë ato që shohim dita-ditës prej përpjekjeve të njerëzve që kapen fort mbas Islamit, të cilët rendin drejt tij dhe e mbrojnë atë. Janë adhurimet e tyre të sakta dhe mësimi i Sunetit të profetit të tyre, ajo që i afron ata për tek Zoti i tyre dhe fitimi i Xhenetit dhe kënaqësisë së Tij. Fakt i cili duket qartë në rendjen e tyre pas dijetarëve të rrënjësor, që janë të vendosur në dijen e tyre, të sinqertë dhe të palëkundur. Duke përfutur prej dijes së tyre të pastër dhe të kulluar, nëpërmjet pyetjeve dhe metodave të tjera, si dhe duke hulumtuar

mendimet e sakta të dijetarëve dhe atë që është më afër argumentit dhe Sunetit. Kështu largojnë përgjegjësinë dhe u pranohen punët, në një kohë ku janë shtuar mosmarrëveshjet dhe flet çdokush që pretendon se është i ditur, edhe pse dituria është larg prej tij, ose është thjesht një injorant, i çrregullt, ose ndonjë polemizues filozof që e refuzon fenë nëpërmjet logjikës, ose është ndonjë kokëtrashë injorant që pretendon se është i ditur dhe i kulturuar, i cili nuk arrin të dallojë mes detajeve të diturisë dhe të vërtetave të saj.

Njerëzit do të vijojnë të jenë mirë përderisa e marrin diturinë nga të mëdhenjtë dhe të sigurtit (e palëkundur), ndryshe kanë për t'u shkatërruar. E vërteta është e qartë dhe ka dritë mbi vete, ndërsa e kota ka errësira të qarta, të cilat janë të vendosura njëra mbi tjetrën.¹

O muslimanë!

Kushdo që sheh realitetin e njerëzve rreth e rrotull, ka për të hasur në garimin dhe konkurimin e tyre pandalim, në shfrytëzimin në maksimum të energjive që posedojnë rreth arritjeve dhe suksesit në këtë botë. Ata rendin dhe vrapojnë pas bukurive të dynjasë duke vepruar çdo mënyrë dhe duke sakrifikuar gjithçka për arritjet e rezultateve të larta në të, duke shpenzuar gjithë potencialin e tyre fizik dhe shpirtëror, duke përdorur lloj lloj rrengash dhe hilesh, vetëm e vetëm që të

¹ Shumë prej njerëzve nuk arrijnë të dallojnë mes dijetarit dhe nxënësit të dijes, thirrësit, predikuesit, imamit të xhamisë, muezinit, mendimtarit, lexuesit të Kur'anit, atij që këndon rukje, prezantuesit të emisioneve islame, studentit të Fakultetit të Sheriatit, konsulentit shoqëror dhe poetit musliman. Ata i vendosin të gjithë këta në një rreth pa dallim, duke i konsideruar të barabartë në dituri, fetva dhe të aftë për udhëheqjen e këtij populli.

arrijnë stolitë dhe bukuritë e kësaj bote. Nuk mjaftohen vetëm me kaq, por edhe qortojnë dhe shohin me nënçmim këdo që nuk bën si ata, aq sa e akuzojnë si të çmendur. Aq sa njerëzit mësojnë njëri-tjetrin se si mund të arrihen rezultatet e larta në dynja, organizojnë seminare dhe konferenca rreth metodave se si mund të shfrytëzohen rastet dhe mundësitë që u vijnë njerëzve dhe se si mund të bëhesh i pasur në këtë botë. Por vallë, a jemi përpjekur ndonjëherë rreth projekteve të botës tjetër dhe të studiojmë hollësisht se si mund t'i realizojmë këto projekte në formën më të mirë? A vallë ka për t'i qortuar babai fëmijët dhe shoku shokun e tij për humbjen e këtyre rasteve? A do të ketë vallë ndonjë lloj bashkëpunimi dhe këshillimi mes tyre dhe a do t'i përdorin vallë mjetet e komunikimit, rrjetet sociale, reklamat, mesazhet, aparatet celulare dhe kurset përkatëse, ashtu siç i përdorin në organizimet e çështjeve të dynjasë?

E sheh që shqetësohet për humbjen e monedhës së argjendit,

Dhe nuk shqetësohet aspak për humbjen e fesë së tij.

Të nderuar vëllezër! Projekti më madhështor lind bashkë me njeriun që kur arrin moshën e pjekurisë, e derisa të dalë nga kjo botë. Ky projekt, është projekti me Allahun. Projekt për të cilin besimtari shqetësohet gjithnjë, në çdo çast të natës apo të ditës, kur është në vendin e tij apo në udhëtim. Ai gjithnjë sillet rrotull shpresës dhe frikës dhe dorën e ka të vendosur mbi zemër. Ai hidhërohet dhe pikëllohet sa herë që e godet ndonjë çrregullim ose dëmtim dhe gjithnjë e ripërtërin besimin e tij dhe e përmirëson gjendjen e tij, si dhe mendohet

shpesh rreth udhëtimit dhe vendkthimit. Ngaqë ai nuk e di përfundimin e projektit të tij, a vallë do të jetë fitues apo humbës? Gjuha e tij nuk pushon së luturi në mëngjes dhe mbrëmje, që Allahu ta kurorëzoj me sukses dhe të jetë prej fitimtarëve, fitues dhe triumfues. Ai në disa prej netëve nuk fle vetëm se pak, sepse është në frikë dhe panik nga fundi i rrugëtimit dhe projektit. Aq sa nuk mund të ha dhe të pi në disa prej ditëve, ngaqë është i shqetësuar për suksesin e madh dhe për fitoren e bujshme. Ai është i frikësuar dhe i lemerisur nga humbja, e çfarë humbje është ajo!? Kjo është situata e të falimentuarve që kanë investuar në çështjet e dynjasë dhe kjo është gjendja e besimtarëve fitimtarë dhe ngadhënjimtarë, investitorëve në çështjen e Ahiretit.

Nëse dynjaja i jep njeriut fenë e tij,

Ai nuk është i humbur në atë që humbet prej saj.

O investitorë! Pas disa ditësh do të mbërrij tek ne një projekt nga projektet e botës tjetër, një tregëti fitimprurëse me Allahun e Lartësuar Madhështor, ku çdokush prej besimtarëve do të shijoj ëmbëlsinë e besimit, si dhe lodhjet e mundimet, vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Ky është muaji i agjërimit dhe i faljes së natës, muaji i bindjeve dhe mirësive, muaji i derdhjeve të lotëve dhe i hapjes së zemrave. Muaji në të cilin shumëfishohen shpërblimet dhe punët e mira. Muaji i lirimimit nga zjarri dhe i fitimit të trojeve të Xheneteve, e mbi të gjitha këto të kënaqurit e Mëshiruesit. Muaji në të cilin qethen instinktet dhe pastrohen shpirtrat, të cilat shkojnë drejt asaj që kënaq Sunduesin Madhështor. Muaji i udhëtimit të zemrave drejt Njohësit të të fshehtave. Muaji i

mëshirës, paqes dhe bamirësisë. Muaji i garimit, konkurimit, nxitimit dhe fitimit. Muaji i përpjekjes dhe i durimit. Muaji i adhuruesve, besimtarëve të mirë, të përgjyerve dhe të përgjyeruarve. Sa i bukur është ky muaj! Sa i mrekullueshëm dhe sa mahnitës është!?

Një rast i mirë për të njohur veten dhe potencialin e saj, për ngritjen e shpirtit dhe zemrës duke i zbardhur, pastruar dhe kulluar ato. Si dhe një përpjekje për të arritur kënaqësinë e Allahut dhe ngritjen në gradët e Xheneteve dhe lirim nga zjarri.

Çdokush që posedon logjikë dhe mendje të shëndoshë, habitet dhe çuditet me ato zemra të ashpëra, të pakujdesshme, të vrazhda, të kreshta dhe të pavëmendshme ndaj Allahut në këtë muaj madhështor, edhe pse rreth e rrotull shikon mësim dhe përkujtime, grupime njerëzish të frikësuar ndaj Allahut të Lartësuar, të trembur dhe të kthyer drejt Allahut. E megjithatë, nuk preken dhe nuk lëvizin drejt Zotit të tyre, qoftë edhe vetëm në këto ditë, në të cilat ambjenti është mjaft i përshtatshëm për t'u afruar dhe jo për t'u larguar. Prandaj, le kthehemi tek Allahu dhe Libri i Tij dhe të përpiqemi të realizojmë devotshmërinë dhe pendimin e sinqertë. Le t'u kërkojmë llogari veteve tona dhe të largohemi nga gjynahet dhe kundërshtimet, që të arrijmë fitoren dhe lirim nga zjarri.

Duke u nisur nga pikënisja hyjnore profetike madhështore: Bashkëpunimi me njëri-tjetrin në mirësi dhe devotshmëri, nga e drejta e vëllazërisë dhe dashurisë dhe nga përpjekja në përhapjen e mirësisë dhe ditorisë, unë shkruajta këtë libër rreth normave të agjërimit.

E quajta: “Pajisja e agjëruesit” dhe përmban dyqindë çështje. Synova që të jetë i vogël, që mbahet lehtë dhe kuptohet thjeshtë. U përpoqa që agjëruesi të gjej në të çdo gjë që dëshiron dhe e grumbullova atë nga librat e Sunetit Profetik dhe shpjegimet e tyre, nga fjalët e sahabëve dhe tabi’inëve, nga fjalët e katër imamëve: Ebu Hanife, Maliku, Shafiu, Ahmedi dhe pasuesit e tyre, si dhe nga imamët e tjerë të Islamit dhe dritave të udhëzimit ² (Allahu i mëshiroftë dhe i shpërbleftë me të miral!). Përzgjedha atë që shpresoj të jetë më afër argumentit dhe arsyes tek ata që janë kompetent në këtë fushë me lejen e Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: *﴿Nëse nuk pajtobeni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit.﴾* (En-Nisa’: 59) Kush dëshiron të zgjerohet më tepër, le të shikojë librat e dijetarëve.

E lus Allahun që të jetë nga pajisjet më të mira për ditën e kthimit dhe të na largoj nga gabimet dhe boshllëqet në fjalë dhe punë. Që të jetë i dobishëm, i saktë dhe i pranuar.

² Lexues i nderuar! Gjatë shfletimit të këtij libri do të hasësh shprehjen “Shumica e fukahave”. Siç e di mirë, që medh’hebet e Fikhut që merren në konsideratë janë katër: Ebu Hanife, Maliku, Shafiu dhe Ahmedi dhe siç e di që mes tyre dhe pasuesve të tyre ka mendime të ndryshme rreth degëzimeve të shkencës së Fikhut. Kështu që, kur dy ose tre prej tyre bien dakord për një çështje, përballë njërit prej tyre, ata konsiderohen shumicë. Me shprehjen “disa prej fukahave” kam për qëllim njërin medh’heb ose dy medh’hebe përballë dy medh’hebeve. Me shprehjen “një pjesë e fukahave” kam për qëllim mendimet e tjera jashtë këtyre katër medh’hebeve, ose mendimet e dijetarëve brenda medh’hebit. Zemrat tona duhet të jenë të shëndosha ndaj këtyre mosmarrëveshjeve dhe të edukohemi me normat e mosmarrëveshjes. Pasimi i medh’hebeve nuk duhet të shkaktoj fanatizmin, përçarjen dhe urrejtjen mes muslimanëve. Imamët nuk i dhanë këto mendime që njerëzit të jenë fanatik pas tyre dhe të lënë mënjanë argumentet. Madje ata kanë thënë: “Nëse hadiithi është i saktë, merre atë dhe lëre mendimin tim.”

Siç e lus Atë që kjo të jetë një punë e mirë gjatë jetës dhe pas vdekjes, për mua, prindërit e mi dhe për familjarët e mi, ditën që do të shpërndahen punët e mira.

O agjërues, kudo që jeni! Ju përshëndes me përshëndetjen më të bukur nga vendi i shenjtë i Mekës, vendi i Islamit dhe Kur'anit dhe vendlindja e të Dërguarit të Allahut (ﷺ) dhe përshëndetjet janë çelësat e zemrave. Po ju dhuroj një dhuratë që përmban rrugëtimin e zemrave, nëpërmjet diturisë, përkujtimit dhe Librit.

Muslimani nuk i dhuron vëllait të tij ndonjë dhuratë më të mirë se fjala e urtë, me të cilën Allahu ia shton udhëzimin, ose e pengon nga e keqja.





Së pari:

Temat që kanë të bëjnë me kushtet e agjërimit, detyrat e tij dhe gjykimet e atyre që e prishin agjërimit



Së pari: Temat që kanë të bëjnë me kushtet e agjërimit, detyrat e tij dhe gjykimet e atyre që e prishin agjërimit

1- Agjërimi është detyrë për çdo musliman që ka mbushur moshën e pjekurisë, të logjikshëm, që ka mundësi (të agjëroj), që është në vendin e tij dhe që është i lirshëm nga pengesat (si menstruacionet dhe lehonja).

2- Kush e lë atë duke kundërshtuar detyrimin e tij, ai ka mohuar, sepse ka rrëzuar një shtyllë prej shtyllave të Islamit. Ndërsa kush e lë për shkak të përtacisë dhe duke e nënvlerësuar, ai është ngarkuar me një gjynah të rëndë dhe i është paraqitur një rreziku të madh.

3- Nëse një pabesimtar përqafton Islamin dhe nëse një fëmijë arrin moshën e pjekurisë gjatë muajit të Ramazanit, ata e kanë për detyrë të agjërojnë pjesën e mbetur nga muaji i Ramazanit dhe nuk e kanë detyrë të zëvendësojnë ditët e kaluara të tij, sipas mendimit unanim të dijetarëve.

4- Nëse një pabesimtar përqafton Islamin dhe nëse një fëmijë mbush moshën e pjekurisë gjatë ditës, ata duhet të agjërojnë pjesën e mbetur të asaj dite dhe jo ta zëvendësojnë atë ditë me agjërimitin e një dite tjetër.

5- Nuk lejohet të agjërohet dita që është para muajit të Ramazanit, me përjashtim të rastit kur dikush e ka zakon të agjëroj disa sunete, si dita e hënë ose e enjte, ose kur ka për të zëvendësuar ndonjë ditë. Profeti (ﷺ) thotë: “*Të mos i paraprij asnjëri prej jush Ramazanit me agjërimitin e një dite ose*

dy ditë para tij, me përjashtim të atij që e ka patur zakon të agjëroj ndonjë ditë, ai le ta agjëroj atë ditë.”³

6- Banorët e çdo vendi pasojnë shikimin e tyre të Hënës së re, për fillimin dhe mbarimin e muajit, por nëse ata nuk kanë një shikim të veçantë të tyre, atëherë duhet të pasojnë vendin më të afërt Islam që i kushton vëmendje shikimit të hënës së re. Muslimanët e një vendi nuk duhet të kenë mosmarrëveshje dhe as nuk duhet të përçahen në këtë çështje, ngaqë përputhshmëria në fillimin dhe mbarimin e agjërimin në një ditë, së bashku të gjithë, përmbush një synim madhor prej synimeve të Sheriatit. Kështu që, një mendim jo i saktë me të cilin realizohet synimi i bashkimit dhe afrimit, është më i mirë se një mendim i saktë që shkakton përçarje dhe mosmarrëveshje, kur bëhet fjalë për çështjet ku ka hapësirë dhe ku pranohet mendimi ndryshe.

7- Në agjërimin farz (të obligueshëm), nijeti duhet bërë medoemos natën, sepse profeti (ﷺ) thotë: *“Kush nuk e bën nijetin për agjërim para se të hyj agimi i mëngjesit, nuk ka agjërim për të.”*⁴ Duke iu referuar mendimit më të saktë të dijetarëve, mjafton një nijet i vetëm në fillim të muajit të Ramazanit, me përjashtim të rastit kur e ndërpret agjërimin për shkak të sëmundjes ose udhëtimit, sepse atëherë duhet ta ripërtërijë nijetin kur të rifilloj agjërimin. Ky është mendimi i një grupi dijetarësh. Ndërsa disa të tjerë thonë që nijeti duhet bërë çdo natë, ky është edhe mendimi i shumicës së fukahave,

³ E transmeton Buhariu (1914) dhe Muslimi (1082).

⁴ E transmeton Nesai (2331) dhe e ka saktësuar Bejhekiu, Darakutnij, Khattabij, Abdul-Hakki dhe ibën El-Xheuzij prej fjalës së profetit (ﷺ), ndërsa prej fjalës së sahabiut e ka saktësuar Tirmidhiu dhe Ebu Hatimi.

por me sa duket, mendimi i parë është më afër të vërtetës, ngaqë çdokush në fillim të muajit e bën nijet të agjëroj të gjithë muajin dhe kështu gjykimi i nijetit i përfshin të gjitha ditët edhe pse realisht nuk bëhet çdo ditë.

8- Vendi i nijetit është në zemër, kështu që nuk është prej fesë dhe as nuk është kusht që nijeti të shprehet me gjuhë, sepse një gjë e tillë nuk ka ardhur në Sunetin e të Dërguarit (ﷺ) dhe po ashtu nuk e kanë vepruar as Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

9- Në agjërimin nafile (sunet), nijeti mund të bëhet në çdo kohë të natës apo të ditës. Ky është mendimi i pjesës më të madhe të fukahave. Argument për këtë është fjala e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!): *“Një ditë profeti (ﷺ) erdhi tek unë dhe më tha: “A keni ndonjë gjë për të ngrënë?” Ne i thamë: Jo. Atëherë ai tha: “Unë jam i agjërueshëm.”*⁵

10- Atij i quhet savap dhe shpërblehet që nga momenti që e bën nijet agjërimin nafile dhe ky është mendimi i disa fukahave, sepse punët janë sipas nijetit (qëllimit).

11- Ngrënia e syfyrit ose darkës është argument për nijetin e agjërimit, sepse njeriu e ha syfyrin që të agjëroj dhe e gjithë nata është kohë që mund të bëhet nijeti i agjërimit.

12- Ai që ka rënë pa ndjenja, ka dy raste:

a) Ai që ka rënë pa ndjenja në një pjesë të ditës dhe këtij i quhet agjërimi, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse ai e ka arritur adhurimin në kohën përkatëse.

5 E transmeton Muslimi (1154).

b) Ai që ka rënë pa ndjenja natën para sabahut e deri në perëndim të diellit, ai si ta bëj njetin e agjërimit, si mos ta bëj, nuk i quhet agjërimi, sipas mendimit të shumicës së fukahave, ngaqë nuk e ka patur logjikën gjatë kohës së agjërimit. Kjo çështje është referencë për temat e aksidenteve, ndërhyrjeve kirurgjikale etj.

13- Ai që ka rënë pa ndjenja dhe është në gjendje koma gjatë gjithë muajit të Ramazanit dhe më pas përmendet. Në këtë rast ai duhet të zëvendësoj të gjitha ditët që ishte sëmurë, sipas mendimit të katër imamëve, ngaqë ai ishte i sëmurë dhe kur u shërua duhet t'i zëvendësoj të gjitha ato ditë.

14- I moshuari dhe i sëmuri që nuk mundën as të agjërojnë dhe as t'i zëvendësojnë ato ditë më pas. Ata duhet të ushqejnë për çdo ditë nga një të varfër, me një ushqim të bollshëm për t'u ngopur - të gatuar ose të pagatuar - dhe nuk ka argument për përcaktimin e masës së ushqimit, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve. Ngaqë rregulli thotë, se në rastet kur nuk ka ardhur argument për përcaktimin preçiz të diçkaje, atëherë kthehemi tek ajo që njohin njerëzit dhe këtë e kanë thënë disa prej komentatorëve të Kur'anit. Jepet ushqim dhe nuk jepet në vlerë monetare, sipas mendimit të shumicës së fukahave, duke respektuar tekstin sheriatik, duke punuar dhe duke e madhëruar atë, aq më tepër që nuk njihet asnjë kundërshtar i sahabëve, që janë Aliu, Ibën Umeri dhe Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

15- Ushqimi si shpërblim u jepet vetëm fukarenjve dhe të varfërve dhe jo të tjerëve prej llojeve që u jepet zekati, ngaqë në Kur'an u përmendën vetëm këta, sipas mendimit të shumicës së fukahave.

16- Nëse ai që nuk mundet të agjërojë udhëton, nuk i bie dhënia e ushqimit si shpërblim, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, si dhe për mungesë argumenti.

17- Dhënia e ushqimit si shpërblim nuk quhet nëse jepet para muajit të Ramazanit, kjo është një çështje për të cilën nuk ka mosmarrëveshje. Gjithashtu nuk quhet nëse jepet në fillim të muajit për gjithë Ramazanin. Po ashtu nuk quhet nëse jepet para ditës përkatëse, sepse kështu dha shpagimin para se të ndodhë shkaku. Ndërsa shtyrja e asaj dite për më pas, është e lejueshme.

Shënim: Nëse ofron ushqim si shpërblim për çdo ditë, ose çdo dhjetë ditë, ose në fund të muajit, të gjitha këto janë të sakta dhe të lejueshme.

18- Kush nuk ka mundësi të japë ushqim si shpërblim, atij nuk i bie obligimi i dhënies së ushqimit si shpërblim dhe i mbetet si detyrë ta japë atë në momentin që do ketë mundësi, por nëse ndërron jetë para se ta ketë përmbushur këtë obligim, nuk ka asnjë gjë ndaj tij, sipas mendimit të një grupi dijetarësh.

19- Është e lejueshme të jepet vullnetarisht ushqim si shpërblim për atë që nuk mundet të agjërojë, por me lejen e tij. Ky është mendimi i shumicës së fukahave.

20- Nëse ka mundësi të agjërojë pasiqë ka dhënë ushqim si shpërblim, a vallë e ka obligim të agjërojë dhe të zëvendësojë ditët e kaluara? Këtu janë dy gjëra:

- *E para:* Nëse e ka të mundur të agjërojë në po të njëjtën ditë për të cilën ka dhënë ushqim si shpërblim, ai nuk e ka detyrë as ta agjërojë dhe as ta zëvendësojë atë ditë. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, ngaqë ai në momentin që iu drejtua obligimi, u urdhërua të jepte ushqim si shpërblim, gjë të cilën ai e veproi.
- *E dyta:* Nëse e jep ushqimin si shpërblim për ditët që nuk mundej para kohe dhe më pas pati mundësi të agjërojë, atëherë ai e ka detyrë të agjërojë. Ngaqë origjina në dhënien e ushqimit si shpërblim është që të jepet çdo ditë, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, siç e përmendëm edhe më lart.

21- Nëse vonohet në dhënien e ushqimit si shpërblim dhe më pas mundet të agjërojë, ai e ka detyrë të agjërojë, sepse iu dha mundësia të agjërojë para se të fillojë zëvendësimin.

22- Nëse i jepet mundësia të agjërojë (pasiqë nuk mundej) gjatë muajit të Ramazanit, e ka detyrë të agjërojë ditët e mbetura që nga momenti që filloi të ketë mundësi, sepse arsyeja që kishte, nuk ekziston më.

23- I moshuari që ka humbur logjikën dhe nuk arrin të kapë gjërat rrotull tij, ose ai që nuk e ka logjikën në pjesën më të madhe të kohës, ai nuk e ka detyrë as të agjërojë

dhe as të japë ushqim si shpërblim, sepse nuk është i ngarkuar, ngaqë nuk përmbush kushtin e logjikës.

24- Cila është ajo sëmundje, të cilën kush e ka, i lejohe të mos agjërojë? Është ajo sëmundje të cilën kush e ka, e ka të vështirë të agjërojë, ose ajo sëmundje që shtohet më tepër nëse agjëron, ose që frikësohet se agjërimi do ngadalësojë shërimin. Ky është mendimi i katër imamëve. Ngaqë arsyeja e prishjes së agjërimin, është prezenca e vështirësisë dhe mundimit gjatë agjërimin.

25- Llojet e të sëmurëve:

- *I pari:* I sëmuri me një sëmundje që shpreson të shërohet. Ky e prish agjërimin dhe e zëvendëson atë ditë.
- *I dyti:* I sëmuri me një sëmundje që nuk shpreson të shërohet. Ky e prish agjërimin dhe jep ushqim si shpërblim, siç e përmendëm edhe më lart.
- *I treti:* Ai që nuk e di gjendjen e tij. Origjina është që ai e prish agjërimin dhe duhet të presë derisa të shërohet, e pasi të shërohet të zëvendësoj me agjërim ditët që ishte i sëmurë. Nëse ndërron jetë, gjykimi i tij është siç do ta përmendim në rregullat e zëvendësimit të agjërimin, me lejen e Allahut.

26- Llojet e vështirësisë:

a) Vështirësia e përballueshme dhe e zakonitë, si dhimbjet e kokës, dhëmballës, etj., këto lloj vështirësish nuk e lejojnë prishjen e agjërimin.

b) Vështirësitë e papërballueshme dhe të pazakonta, këto lloj vështirësish e lejojnë prishjen e agjërimit.

27- I sëmurit mendor ndahet në disa kategori:

- *E para:* Kur jeton nën efektin e ilaçeve dhe nuk mundet të agjërojë. Në këtë rast gjykimi i tij është i njëjtë me gjykimin e atij që nuk shpresohet të shërohet.
- *E dyta:* Kur i vijnë krizat nervore herë pas here, e ka detyrë të agjërojë dhe kur ka nevojë të kurohet, e prish agjërimin dhe e zëvendëson atë më pas.
- *E treta:* Kur bie pa ndjenja, gjykimi i tij është i njëjtë me gjykimin e atij që bie pa ndjenja, çështje të cilën e sqaruam më lart.
- *E katërta:* Kur pi ilaçet dhe fle gjatë gjithë ditës, agjërimi i tij është i saktë unanimisht.
- *E pesta:* Kur gjendja e të sëmurit mendor është e njëjtë me gjendjen e të çmendurve, ose ka sëmundjen daun, etj., atëherë janë disa raste:

a) Kur e ka humbur logjikën dhe nuk arrin të spikat mes gjërave dhe nuk shpresohet që të shërohet. Në këtë rast ai nuk e ka detyrë as zëvendësimin dhe as ushqimin, sepse nuk është i ngarkuar me obligime.

b) Kur është i logjikshëm dhe arrin t'i spikati gjërat, ai e ka detyrë të agjërojë. Por nëse nuk mundet, atëherë për të jepet ushqim si shpërblim, siç e përmendëm më lart.

c) Kur e ka humbur logjikën dhe më pas përmendet gjatë muajit të Ramazanit, ai nuk e ka detyrë të agjërojë ditët e kaluara, por e ka për detyrë të agjërojë pjesën e mbetur të muajit të Ramazanit. Ky është mendimi i disa fukahave, ngaqë iu rikthye edhe logjika edhe spikatja.

d) Kur e ka humbur logjikën gjatë gjithë muajit të Ramazanit, ai nuk e ka detyrë zëvendësimin, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse nuk ka qenë i ngarkuar me obligimet.

e) Kur e ka humbur logjikën gjatë gjithë ditës, nuk e ka detyrë të agjërojë dhe nuk quhet prej tij edhe nëse agjëron, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse nuk ka qenë i ngarkuar dhe nuk e ka detyrë zëvendësimin, sipas mendimit të disa fukahave, siç e përmendëm edhe më lart.

f) Kur përmendet në një pjesë të ditës, e ka detyrë agjërimin, por nuk e ka detyrë zëvendësimin, sipas mendimit të disa fukahave, sepse pas ardhjes së logjikës, ai konsiderohet i ngarkuar me obligimet.

28- Gratë shtatzëna dhe ato që i japin gji fëmijëve, kanë tre raste:

- *I pari:* Kur e kanë të vështirë agjërimin, ato duhet vetëm të zëvendësojnë pa dhënë ushqim si shpërblim, sipas mendimit të katër imamëve.
- *I dyti:* Kur frikësohen vetëm për shëndetin e foshnjës ose fëmijës, mendimi më i saktë nga dy mendimet e dijetarëve, është se e kanë detyrë ta zëvendësojnë atë ditë. Madje ky është edhe mendimi i disa tabi'inëve si Ata', Nakhaij, Zuhrij

dhe i disa fukahave. Argument për këtë është fjala e Allahut: *﴿Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar.﴾* (El-Bekare: 185)

Përsa i përket asaj që ka ardhur nga Ibën Abasi dhe Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dyl!)⁶, se është detyrë vetëm ushqimi pa zëvendësim, ka disa përgjigje:

Se kjo që ata zgjodhën argumenton se është e pëlqyeshme (dhe jo detyrë), ose është një këndvështrim i tyre që bie ndesh me tekstin sheriatik, ose jepet ushqimi si shpërblim me gjithë detyrimin e zëvendësimit, sepse për rrëzimin e zëvendësimit lypset një argument i qartë, i dukshëm dhe bindës. Plus faktit që origjina është zëvendësimi dhe kjo origjinë nuk mund të rrëzohet nga një argument, prej të cilit kuptohen disa gjëra, aq më tepër që agjërimi është një shtyllë prej shtyllave të Islamit. Sikur të ishte vetëm mendimi për ushqim si shpërblim, do të ishte e njohur mes sahabëve dhe do na përcillej edhe neve qartësisht, pa lënë hapësira për mëdyshje, veçanërisht kur kjo është një çështje jetike. Por nëse jep ushqim si shpërblim bashkë me zëvendësim, kjo është akoma më mirë, duke dalë nga kjo mosmarrëveshje, mendim të cilin e zgjodhi Ibën Umeri dhe disa prej tabi'inëve si Muxhahidi, Haseni dhe Nakhajj.⁷

⁶ E transmeton Darakutnij me zinxhir transmetimi të saktë (2382, 2388).

⁷ E transmeton Abdurrazzaku në "Musannafin" e tij (7558), Tefsiri i Ibën Ebi Hatim (1/308).

- *I treti:* Kur ato frikësohen për veten dhe për fëmijët e tyre, gjykimi i tyre është i njëjtë me gjykimin e rastit të dytë, sipas mendimit më të saktë.

Shënim: Rregullat e ushqimit në këto raste, janë të njëjta me ushqimin si shpërblim për atë që nuk mundet të agjërojë.

Shënim: Ushqimi si shpërblim jepet vetëm për një, edhe nëse janë më shumë fëmijë ose foshnja (kur ka binjak, etj.), sipas mendimit më të saktë, ngaqë ushqimi është në vend të agjërimin.

Shënim: Ushqimin duhet ta japë babai dhe jo nëna, sipas mendimit më të saktë, sepse ai e ka për detyrë të shpenzojë për ta.

29- Ata që e prishin agjërimin për interes të dikujt tjetër, si ai që e prish agjërimin për të shpëtuar dikë që po mbytet, ose një të sëmurë, etj., gjykimi i tij është i njëjtë me gjykimin e gruas shtatzënë dhe të asaj që i jep gji fëmijës, kur ato e prishin agjërimin vetëm për interes të foshnjës dhe të fëmijës. Ky është mendimi i disa fukahave.

30- Kush e prish agjërimin për interes të dikujt tjetër, nuk e ka obligim të vazhdoj agjërimin e pjesës së mbetur nga ajo ditë, në të cilën e prishi agjërimin, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, sepse nuk ka asnjë dobi në këtë rast, aq më tepër që argumenti që detyron vazhdimin e agjërimin është i dobët.

31- Gruaja e cila pastrohet nga menstruacionet gjatë ditës, nuk e ka detyrë të vazhdojë agjërimin e pjesës së mbetur të asaj dite, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, të cilin e kanë zgjedhur disa prej

fukahave. Argument për këtë, është ajo që përmendëm në temën e kaluar.

32- Nëse ajo pastrohet para namazit të sabahut dhe lahet pas sabahut, agjërimi i saj është i saktë. Ky është edhe mendimi i shumicës së fukahave.

33- Ajo grua që e di se menstruacionet i ka të çrregullta dhe që mund t'i vijnë, ajo nuk duhet të bëj nijet që do ta prishë agjërimin dhe gjithashtu të mos e bëj nijetin në formë të prerë se do agjërojë. Ajo të presë derisa të zgjohet nga gjumi dhe kur të zgjohet, nëse i ka ende menstruacionet, atëherë të mos agjërojë, në të kundërt, të agjërojë. Ajo nuk duhet ta ketë nijetin me mëdyshe midis agjërimit dhe mos agjërimit.

34- Gjakderdhja dhe hemoragjia [që nuk është për shkak të menstruacioneve dhe as të lehonisë (por për shkaqe të tjera)] nuk e pengon faljen e namazit dhe as agjërimin, sipas mendimit unanim të dijetarëve. Argumentet për këtë janë të shumta.

35- Hemoragjia që del nga organi gjenital i gruas dhe që ka ngjyrë të verdhë (të përtafërt me qelbin) dhe hemoragjia që ka ngjyrë të mesme mes të verdhës dhe të zezës, ndahet në disa lloje:

- *I pari:* Nëse del para kohës së menstruacioneve, nuk e prish agjërimin.
- *I dyti:* Gjatë kohës së menstruacioneve dhe në këtë rast gjykimi i asaj gjakderdhje, është i njëjtë me gjykimin e menstruacioneve.
- *I treti:* Kur del në fund të periudhës së menstruacioneve dhe para se të pastrohet. Edhe në këtë rast, merr gjykimin e menstruacioneve.

- *I katërti:* Kur kjo gjakderdhje del pas pastrimit, ajo nuk e prish agjërimin. Argument për këtë është hadithi i Umu Atijes (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e cila thotë: “Ne gjakderdhjen me ngjyrë të verdhë dhe atë me ngjyrë të mesme mes të zezës dhe të verdhës, nuk e merrnim fare në konsideratë kur ishte pas pastrimit.”⁸

36- Agjërimi i zhytësave ose i pjesëmarrësve në garat e notit, ndahet në dy raste:

- *I pari:* Nëse ai mendon se nuk mund t’i depërtojë uji në stomak nga goja ose hunda dhe e di mirë notin, aq sa mund ta ruaj agjërimin e tij, atëherë ai e ka të lejueshme dhe gjykimi i tij është i njëjtë me gjykimin e atij që lahet me ujë të ftohtë. Ky është edhe mendimi i katër imamëve.
- *I dyti:* Nëse ai mendon se uji mund t’i depërtojë në stomak për shkak të notit ose zhytjes, atëherë atij nuk i lejohet ta bëj këtë dhe e ka të ndaluar të notoj ose të zhytet në Ramazan, sepse kështu do ta prishi qëllimisht agjërimin dhe do ta paraqesë agjërimin e tij në rrezik.

37- Nëse hyn në ujë të notojë dhe e gëlltit ujin pa dashje, agjërimi i tij është i saktë, duke iu referuar mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që njëkohësisht është edhe mendimi i disa prej dijetarëve.

⁸ E transmeton Ebu Daudi (307) dhe origjina e tij është tek Buhariu, por pa përmendur “pastrimin”.



Së dyti:

**Temat që kanë të bëjnë me kohën e
ngrënies së syfyrit dhe iftarit**



Së dyti: Temat që kanë të bëjnë me kohën e ngrënies së syfyrit dhe iftarit

Sqarim: Shumë prej njerëzve sa hapin sytë nga gjumi para namazit të sabahut, menjëherë hanë ose pijnë para se të sigurohen se ka hyrë agimi i mëngjesit apo jo, edhe pse është tepër e thjeshtë të sigurohesh. Pra duhet të sigurohemi para se të hamë ose të pijmë.

38- Referenca ndaj mjeteve të reja të komunikimit për kohën e syfyrit dhe çeljen e iftarit, ndahet në dy lloje:

- *I pari:* Nëse mjete të komunikimit është i saktë, si aparati celular, televizioni, stacionet e drejtpërdrejta të radios, nëse janë të rregullta me kohën, atëherë është e lejueshme t'u referohesh atyre, duke i krahasuar me dëgjimin e ezanit nga një muezin i sigurtë.
- *I dyti:* Nëse mjete të komunikimit nuk është i rregullt, si aparati celular që nuk është i qëndrueshëm për rregullsinë e kohës, ose ezani i inçizuar nëpërmjet radio-televizionit, që nuk jepet drejtpërdrejtë, atëherë nuk lejohet t'u referohemi atyre, duke i krahasuar me mos lejimin e çeljes së iftarit dhe ngrënies së syfyrit në rastin kur muezini nuk është i sigurtë.

Shënim: Është e lejueshme t'u referohesh programeve që vendosen në aparatet celulare, etj. me kusht që firmat që

i realizojnë ato, të jenë të njohura për saktësinë, korrektësinë dhe përputhjen me kalendarët përkatës, si dhe duke u siguruar për rregullsinë e programeve brenda aparatit që po përdoret, përderisa e ke të pamundur të njohësh mjetin e drejtpërdrejtë, si ezani.

39- Nuk lejohet pirja e ujit ose ngrënia (në kohën e syfyrit), ndërkohë që muezini po thërret ezanin. Duhet ta ndërpresim ngrënien dhe pirjen me fillimin e ezanit. Ndërsa, përsa i përket hadithit: “*Nëse ndonjëri prej jush dëgjon ezanin dhe enën e ka në dorën e tij, të mos e ulë atë, derisa të përfundoj atë që do prej saj.*”⁹ Përgjigjia për të është si vijon:

- a) Ky hadith nuk është i saktë nga i Dërguari (ﷺ).
- b) Nëse ky hadith do ishte i saktë, ndoshta ka qenë në fillim të Islamit, ose është për atë që e befaso i ezani dhe nuk e di kohën, ose dyshonte për kohën. Ndërsa ai që e di kohën dhe e dëgjon ezanin dhe pi, ta dijë mirë se ky hadith nuk ka asnjë lidhje me të. Siç dihet se argumenti i cili lë të kuptohen një sër hipotezash, nuk merret si argument dhe bie argumentimi me të, sepse konsiderohet prej atyre që nuk janë krejtësisht të qarta. Pra ky argument, është i dyshimtë si në saktësinë e tij, ashtu edhe në kuptimin e tij. Aq më tepër që nuk mund t’i jepet përparësi të dyshimtës dhe të lihet ajo që është e sigurtë, që është hadithi i profetit (ﷺ): “*Bilali e thërret ezanin natën. Ju hani dhe pini derisa të thërrasë ezanin Ibën Umi Mektumi.*”¹⁰

⁹ E transmeton Ahmedi (9474), Ebu Daudi (2350). “Bejanul-uehmi uel-ijham” (2/282), “Ëilelul-hadijthi” i Ibën Ebi Hatim (2/235) dhe “Sunenul-kubra” i Bejhekiut (4/368).

¹⁰ E transmeton Buhariu (2656) dhe Muslimi (1092).

40- Çfarë gjykimi ka agjërimi i atij që ha ose pi duke menduar se është ende natë, por më pas mëson se ka lindur agimi i mëngjesit?

Për këtë çështje ka mosmarrëveshje mes dijetarëve (Allahu i mëshiroftë!):

Mendimi i parë: Ai duhet të vazhdojë agjërimin e asaj dite dhe duhet edhe ta zëvendësojë atë ditë. Ky është mendimi i Ebu Sejid El-Khudrij dhe Ibën Mes'udit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) dhe përzgjedhja e katër imamëve.

Mendimi i dytë: Agjërimi i tij është i saktë dhe nuk duhet ta zëvendësojë atë ditë. Ky është mendimi i Muxhahidit dhe Hasenit. Por mendimi i parë është më i sigurtë, veçanërisht në kohët e sotme, që është lehtësuar jashtëzakonisht njohja e kohës, e megjithatë, neglizhenca e disa njerëzve është tepër e dukshme, siç e cekëm edhe më lart. Ndërsa agjërimi i atij që nuk neglizhon aspak, është i saktë. Argument për të është hadithi i Sehël ibën Se'ad, i cili thotë: Zbriti fjala e Allahut: *«Dhe hani e pini derisa të dallohet fjala e bardhë (bardhësia) e agimit nga fjala e zezë (errësira e natës).»* dhe nuk kishte zbritur ende “e agimit”. Disa burra kur donin të agjëronin, lidhnin në këmbët e tyre një fije të bardhë dhe një fije të zezë dhe vazhdonin të hanin derisa të dallonin qartësisht shikimin e tyre. Më pas Allahu zbriti pas saj: *«e agimit»*¹¹ Ata nuk u urdhëruan për zëvendësim, për shkak të paditurisë së tyre.

41- Kush ha duke qënë në mëdyshje rreth faktit, se a ka perënduar dielli apo jo dhe nuk është i sigurtë për këtë, ai duhet ta zëvendësojë këtë ditë. Kjo është një çështje

11 E transmeton Buhariu (1916) dhe Muslimi (109).

për të cilën nuk ka mosmarrëveshje, sepse nuk lejohet çelja e iftarit kur dyshon dhe kur nuk je i sigurtë.

42- Kush ha duke dyshuar, se a ka perënduar dielli apo jo, por që më pas vërejtë se kishte ngrënë pas perëndimit të diellit, ai nuk duhet ta zëvendësojë atë ditë. Kjo është një çështje për të cilën nuk ka mosmarrëveshje.

43- Kush ha duke menduar se dielli ka perënduar, por që më pas vërejtë se dielli nuk kishte perënduar, a duhet ta zëvendësojë atë ditë?

Kjo është një çështje për të cilën ka mosmarrëveshje mes dijetarëve:

Mendimi i parë: E ka për detyrë ta zëvendësojë atë ditë dhe ky është edhe mendimi i katër imamëve.

Mendimi i dytë: Nuk e zëvendëson atë ditë dhe ky është mendimi i Hasenit, Ata'ës dhe i disa fukahave.

Më afër të vërtetës, është mendimi që thotë se duhet zëvendësuar, mendimi cili është më i sigurtë, aq më tepër që po t'i shohësh argumentet në aparence, duket që janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Porse ka ardhur nga Esmaja vajza e Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) e cila thotë: “Një ditë të vrenjtur e çelëm iftarin në kobën e profetit (ﷺ) dhe më pas doli dielli.” I thanë Hishamit: *A u urdhëruan për zëvendësim? Ai tha: Zëvendësimi duhet medoemos. Ma'ameri thotë: E dëgjova Hishamin të thoshte: Nuk e di e zëvendësuan (atë ditë) apo jo.*¹² Edhe transmetuesit nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) janë të ndryshëm nga njëri-tjetri rreth urdhrin për zëvendësim, por që shumica e tyre kanë përcjellë urdhrin për zëvendësim,

12 E transmeton Buhariu (1959).

E me sa duket, zëvendësimi duket më parësor dhe më afër të vërtetës, veçanërisht në kohët e sotme, ku është lehtësuar mjaft njohja e kohës.

44- Në vendin ku ekziston nata dhe dita, duhet agjëruar e gjithë dita, sado që të zgjasë. Për këtë nuk ka asnjë mosmarrëveshje. Argument për këtë është fjala e profetit (ﷺ): *“Kur vjen nata nga këtu dhe kur ikën dita nga këtu dhe perëndon dielli, atëherë agjërusi e ka çelur iftarin.”*¹³ Kjo është edhe fetvaja e dijetarëve bashkëkohorë. Por nëse dikush frikësohet se mos dëmton veten e tij për shkak të ditës së gjatë, i lejohet ta çeli iftarin duke patur shkak, me kusht që mos neglizhoj dhe më pas ta zëvendësojë atë ditë.

45- Vendi në të cilin nuk dallohet nata nga dita, si p.sh. kur është e gjithë dita vetëm ditë, ose vetëm natë, në këtë rast përcaktohet nata ose dita, ose pasohet vendi më i afërt që ka natë dhe ditë.





Së treti:

**Gjërat që e prishin agjërimin dhe
të ngjashmet me to që kanë dalë në
kohën tonë**



Së treti: Gjërat që e prishin agjërimin dhe të ngjashmet me to që kanë dalë në kohën tonë

Dije, Allahu na mëshiroftë: Se rregullat që ndoqa për të renditur gjërat bashkëkohore që e prishin agjërimin, janë si vijon:

- **Rregulli i parë:** Çdo gjë që depërton në stomak nëpërmjet një rruge të zakonit si goja ose hunda, qofshin ushqyese ose jo ushqyese, e prish agjërimin.
- **Rregulli i dytë:** Çdo gjë ushqyese që hyn në trup nga një praktikë jo e zakonit, ajo e prish agjërimin.

46- Ngrënia dhe pirja nëpërmjet gojës, ose hundës, etj. prej gjërave që e prishin agjërimin, e prishin atë, sipas mendimit unanimit të dijetarëve.

47- Menstruacionet dhe lehonja, unanimitisht.

48- Nxjerrja qëllimisht e të vjellës, ndërsa kur del pa qëllim nuk e prish agjërimin. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, madje për këtë çështje kanë përcjellë edhe unanimitetin. Argument për këtë është fjala e profetit (ﷺ): *“Kush vjell pa vullnetin e tij duke qënë agjëruar, nuk e ka detyrë ta zëvendësojë atë ditë agjërimi. Ndërsa kush e provokon vjelljen qëllimisht, duhet ta zëvendësojë atë ditë agjërimi.”*¹⁴

¹⁴ E transmeton Ebu Daudi (2380) dhe Tirmidhiu (720), si dhe e konsideroi të dobët imam Ahmedi “Mesailu Ebi Daud (fq. 387).

49- Dalja e gjakut, si plagët dhe gël'baza nuk e prish agjërimin. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk ka argument.

50- Pirja e duhanit e prish agjërimin në të katër medh'hebet e imamëve dhe ky është edhe mendimi i dijetarëve në përgjithësi. Ngaqë po fut qëllimisht në barkun e tij diçka të rrezikshme.

51- Pilulat që parandalojnë ataket kardiake, të cilat vendosen poshtë gjuhës, nuk e prishin agjërimin, me përjashtim të rastit kur kapërcen ndonjë prej tyre qëllimisht në stomak. Ndërsa kur zbret diçka pa vullnetin e tij, agjërimi i tij është i saktë.

52- Llojet e pikatoreve:

a) Pikatoret e syrit dhe të veshëve nuk e prishin agjërimin, sepse nuk depërtojnë në stomak dhe nëse depërton diçka e imët pa vullnetin e tij, agjërimi i tij është i saktë, njësoj si shpëlarja e gojës dhe shfryrja e hundës (gjatë abdesit). Ky është edhe mendimi i disa fukahave.

b) Pikatoret e hundës e prishin agjërimin, nëse depërton diçka prej tyre qëllimisht në stomak. Ky është edhe mendimi i katër imamëve. Por nëse depërton diçka pa vullnetin e tij, agjërimi i tij është i saktë, njësoj si shpëlarja e gojës dhe shfryrja e hundës (gjatë abdesit).

53- Gazi i oksigjenit dhe pompat e frymëmarrjes, si p.sh. pompat thithëse, ndahen në dy lloje:

- *I pari:* Ato që nuk përmbajnë lëndë ushqyese të lëngshme ose të thata. Përdorimi i tyre nuk e prish agjërimin, sepse nuk është ushqim.
- *I dyti:* Ato lloj pompash që përmbajnë lëndë ushqyese të lëngshme ose të thata. Ky lloj i pompave e prish agjërimin, sepse depërton në stomak. Vetëm se, kur depërton diçka e imët, ose depërton diçka pa qëllim, agjërimi i tij është i saktë, sepse ngjasohet me rastet e tjera, si shpëlarja e gojës ose shfryrja e hundës gjatë abdesit.

54- Gjilpërat janë disa lloje:

- a) Nëse janë ushqyese, e prishin agjërimin, sepse zënë vendin e ushqimit.
- b) Nëse janë kuruese nuk e prishin agjërimin, sepse nuk zënë vendin e ushqimit.
- c) Nëse janë zbukuruese, nuk e prishin agjërimin, siç e thamë edhe më lart.

Shënim: Rrezet ngjyruese: Me të cilat nënkuptohen gjilpërat kuruese - që përdoren për të zbuluar mitrën -. Edhe këto lloj gjilpërash nuk e prishin agjërimin, sepse nuk konsiderohen ushqim.

55- Të dyja llojet e dializës, nëse e përziejnë gjakun me lëndë ushqyese, e prishin agjërimin, por nëse është thjesht një pastrim i gjakut pa efekte anësore, nuk e prish agjërimin. Gjithashtu thuhet, se edhe ky lloj i fundit e prish agjërimin, sepse gjaku hyn në trup. Gjithësesi, kjo është një çështje që të bën të jesh në mëdyshje, kështu që më e sigurt është ta shtysh dializën për në darkë.

56- Depërtimi i diçkaje nga dy rrugët, nga ku del jashtëqitja dhe urina, si p.sh. për analiza, për t'u pastruar, etj.. Të gjitha këto nuk e prishin agjërimin, mendim të cilin e zgjodhi edhe Komisioni "El-Mexhma'al-Fikhij" për fetva, sepse nuk konsiderohen ushqim dhe nuk depërtojnë në stomak.

57- Përdorimi i pastës së dhëmbëve nuk e prish agjërimin, për arsyt që përmendëm më lart.

58- Çamçakëzi industrial e prish agjërimin, sepse përmban erë të mirë dhe sheqermbajtëse me shije frutash, e ngjyrosur natyralisht ose industrialisht me lëndë kimike, të cilat depërtojnë në barkun e njeriut bashkë me pështymën.

59- Përdorimi i gastroskopit (aparati për të shikuar anën e brendshme të stomakut) është dy lloje:

- *I pari:* Nëse nuk përmban asnjë lëndë mjekësore, nuk e prish agjërimin, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, sepse nuk konsiderohet ushqim.
- *I dyti:* Nëse përmban lëndë mjekësore, e prish agjërimin, sepse ato depërtojnë në stomak.

60- Lyerja e syve me bojë për qepalla është dy lloje:

a) Vendosja e bojës brenda syrit nuk e prish agjërimin, edhe nëse mbërrin shija deri në grykë. Ky është mendimi i disa fukahave, sepse nuk depërton në stomak dhe nuk është ushqyes.

b) Vendosja e bojës jashtë syrit nuk e prish agjërimin, sipas mendimit unanim, sepse nuk hyn në sy.

61- Ngjyerja me këna nuk e prish agjërimin, njësoj si lyerja e syve me bojë, siç e sqaruam më lart.

62- Ngjitësit kirurgjikal dhe llojet e tyre:

a) Ngjitësi nikotin e prish agjërimin njësoj si duhani. Kjo është edhe përzgjedhja e “El-Mexhma’al-Fikhij”.

Disa thonë që nuk e prish, sepse nuk është as ushqim dhe as të pirë. Gjithësesi kjo çështje i nënkupton të dyja mendimet, kështu që më parësore është të evitohet.

b) Ngjitësi që përdoret për pengesën e shtatzanisë nuk e prish agjërimin, sepse nuk është ushqim dhe nuk depërton në stomak.

c) Ngjitësi që eviton urinë nuk e prish agjërimin, sipas mendimit më të saktë, njësoj si çështja para saj, sepse thjesht jep ndjesi dhe nuk është ushqim.

d) Lentja e syrit nuk e prish agjërimin, sepse nuk depërton në stomak dhe nuk është ushqim.

63- Parfumi i lëngshëm nuk e prish agjërimin, sepse është thjesht aromë pa trup dhe sepse nuk depërton në stomak dhe nuk është ushqim.

64- Parfumi reaktiv dhe temjani nuk e prishin agjërimin, duke iu referuar mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, sepse nuk është ushqim dhe në përgjithësi, edhe nëse hyn në gojë nuk depërton në stomak, por edhe nëse hyn diçka, konsiderohet diçka e imët dhe e paqëllimtë.

65- Tymërat dhe avujt që dalin nga fabrikat dhe restorantet edhe nëse i thith agjëruesi, janë njësoj si tema e kaluar.

66- Nxjerrja e gjakut është dy lloje:

- *I pari:* Nëse e nxjerr për shkak të analizave, nuk e prish agjërimin, sepse në përgjithësi nevojitet pak gjak.
- *I dyti:* Nëse e nxjerr për ta dhuruar, më mirë është që ta nxjerr natën, duke dalë edhe nga mosmarrëveshja që është në këtë çështje. Kjo çështje është e njëjtë me çështjen e hixhames, rreth së cilës dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) kanë disa mendime:

Mendimi i parë: Nuk e prish agjërimin, që është edhe mendimi i shumicës së fukahave dhe i Dhahirive.

Mendimi i dytë: E prish agjërimin. Ky është mendimi i Hasenit dhe i disa fukahave të tjerë. Shkak i kësaj mosmarrëveshjeje, është për shkak të larmishmërisë së gjykimeve që ata kanë ndaj saktësisë ose jo të haditheve që kanë ardhur në këtë temë, dhe arsyeja është në faktin se hixhamja e prish ose jo agjërimin.

67- Dalja e gjakut për shkak të goditjeve, çarja e venave, etj. për shkak të kurimit, etj. nuk e prish agjërimin sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që njëkohësisht është edhe mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk ka argument.

68- Gjakderdhja nga hundët, qoftë e qëllimshme ose e paqëllimshme që nuk shkon në fyt, nuk e prish agjërimin, sipas mendimit unanim. Por edhe nëse shkon në

fyt, nuk e prish agjërimin, sipas mendimit më të saktë, që është njëkohësisht edhe përzgjedhja e disa fukahave, sepse është e paqëllimtë dhe është diçka që nuk mund të evitohet.

69- Përdorimi i kimioterapive për të sëmurët me kancer, nuk e prish agjërimin, sepse është injektim i gjakut dhe në përgjithësi nuk mundet të agjëroj.

70- Për injeksionin e gjakut disa thonë që e prish agjërimin dhe disa thonë që nuk e prish agjërimin dhe ky i dyti është më afër të vërtetës, madje edhe “El-Mexhma’al-Fikhij” këtë mendim përzgjedhi, sepse nuk është ushqim që zëvendëson boshllëkun e të ngrënit dhe të pirit. Edhe pse shpirti mbahet gjallë, ai nuk zë vendin e ushqimit dhe të pirit. Gjithësesi, në këtë çështje, çdo mendim ka këndvështrimin e vet dhe më e mira është shtyrja e injeksionit për në darkë.

71- Përdorimi i vajrave dhe kremërave të lëkurës, nuk e prish agjërimin, sepse nuk janë as ushqim dhe as të pirë, e as nuk depërtojnë në stomak.

72- Qetësueset që përdoren për mpirje (si p.sh. eugenoli, vaji i karafililit, etj.) nga goja ose hunda nuk e prishin agjërimin. Nëse qëndron pa ndjenja gjatë gjithë ditës, e zëvendëson atë ditë dhe nëse mbetet pa ndjenja vetëm një pjesë të ditës, atëherë agjërimi i tij është i saktë, siç e përmendëm edhe më sipër.

73- Marrja e mostrave nga pjesët e trupit për kontroll, nëpërmjet gjilpërave, ose mjeteve kirurgjikale, ose copëzave, nuk e prish agjërimin, sepse nuk janë ushqim, përderisa nuk hyjnë lëndët e lëngshme nëpërmjet gojës ose hundës në stomak dhe të prishin agjërimin.

74- Gëlltitja e gëlbazës nuk e prish kategorikisht agjërimin, duke iu referuar mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që njëkohësisht është edhe mendimi i disa fukahave, sepse realisht ato janë sekrecione që vijnë nga kanali i frymëmarrjes dhe nuk janë as ushqim dhe as diçka e ngjashme me të. Vetëm se mos gëlltitja e tyre është më mirë.

75- Gëlltitja e pështymës nuk e prish agjërimin, e grumbullon ose jo atë, madje edhe nëse arrin deri tek buzët. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk është as ushqim dhe as të pirë.

76- Gëlltitja e mbetjeve të ujit me të cilin shpëlahet goja gjatë abdesit nuk e prish agjërimin, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, i cili është edhe mendimi i shumicës së fukahave, sepse është diçka e paevitueshme dhe se është e lejuar gjatë shpëlarjes së gojës gjatë abdesit.

77- Nëse e tepron gjatë shpëlarjes së gojës dhe shfryrjes së hundës gjatë abdesit dhe uji depërton në stomakun e tij, nuk e prish agjërimin, duke iu referuar mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, sepse është diçka e paqëllimtë. Vetëm se, kur e bën këtë gjest qëllimisht, e ka prishur agjërimin, sipas mendimit unanimit.

78- Gargara (shpëlarja e grykës) me ilaçe, etj. nuk e prish agjërimin përdërisa nuk depërton në stomak, por edhe nëse depërton pa vullnet, nuk ka asgjë.

79- Spërkatësi që vendoset për kurimin ditor në pastrimin e dhëmbëve, etj., nuk e prish agjërimin, sepse nuk depërton në stomak dhe nuk është ushqim.

80- Heqja e spiraleve, shkulja e dhëmballëve, thithja e avujve, marrja e mostrave nga trupi për të bërë analizat, nuk e prishin agjërimin, përderisa nuk shoqërohen me gjilpërat qetësuese për gjatë gjithë ditës, siç e sqaruam edhe më lart.

81- Nëse sheh ëndërr dhe vëren se ka dal lëng, nuk e prish agjërimin unanimisht.

82- Dalja e lëngut prostatik (El-medhi - lëngu i bardhë ngjitës që rrjedh nga organet intime) është disa lloje:

- *I pari:* Dalja e tij për shkak të shikimit të parë nuk e prish agjërimin. Kjo është përzgjedhja e shumicës së fukahave. Argument për këtë është hadithi që e transmeton Ibën Burejdeh, nga babai i tij, i cili thotë: I Dërguari i Allahut (ﷺ) thotë: “O Ali! Mos e paso shikimin me shikim tjetër, sepse ke shikimin e parë, por nuk e ke shikimin tjetër.”¹⁵ Ngaqë është e pamundur të mbrohesh nga shikimi i parë dhe për arsye të tjera që do përmenden në vijim.
- *I dyti:* Dalja e tij për shkak të përsëritjes së shikimit, nuk e prish agjërimin, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që njëkohësisht është edhe mendimi i shumicës së fukahave, siç do ta përmendim.
- *I treti:* Dalja e tij për shkak të puthjes, përqaimit, etj., nuk e prish agjërimin, siç e thamë edhe më

¹⁵ E transmeton Ahmedi (1373), Ebu Daudi (2149) dhe Tirmidhiu (2777), i cili e klasifikoi edhe si hadith të dobët.

lart. Ky është mendimi i shumicës së fukahave dhe për faktin se nuk ka argument që thotë se agjërimi prishet me daljen e lëngut prostatik dhe sepse nuk mund të krahasohet me spermën, ngaqë ka mjaft ndryshime mes tyre dhe se është tepër e vështirë të mbrohesh nga dalja e lëngut prostatik.

83- Dalja e spermës ka disa raste:

- *I pari:* Dalja e saj për shkak të shikimit të parë, nuk e prish agjërimin, duke iu referuar mendimit më të saktë dhe për faktin që përmendëm në çështjen e lëngut prostatik, në rastin e parë.
- *I dyti:* Dalja e saj për shkak të përsëritjes së shikimit, e prish agjërimin, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që njëkohësisht është edhe përzgjedhja e disa fukahave, sepse përsëritja e shikimit, bëri që të zbriste edhe spermën.
- *I treti:* Dalja e saj për shkak të puthjes dhe përqaimit, e prish agjërimin, sipas mendimit unanim të dijetarëve.
- *I katërti:* Dalja e saj për shkak të masturbimit, e prish agjërimin. Ky është edhe mendimi i shumicës së fukahave. Argument për këtë është hadithi Kudsij: *“Allahu i Lartmadbëruar thotë: Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të. Ai lë epshin, të ngrënit dhe të pirët për birin Tim.”*⁶ Epshi këtu nënkupton spermën, të cilën e krahasoi me të ngrënit dhe të pirët, që janë prej gjërave që e prishin agjërimin.

84- Atë që e puth bashkëshortja e tij pa pëlqimin e tij dhe i del sperma, nuk e prish agjërimin. Ky është mendimi i të katër imamëve, sepse nuk ishte me pëlqimin e tij.

85- El-Uedi (është një sekrecion i bardhë dhe i trashë që del pas urinimit) nuk e prish agjërimin. Ky është edhe mendimi i disa fukahave, për vetë faktin se origjina është saktësia e agjërimin dhe se nuk ka argument që të faktoj se priset për shkak të tij.

Një dobi: Shkaku i mosmarrëveshjes në shumë prej gjërave që e prishin agjërimin, qofshin të vjetra apo bashkëkohore, ndodhin për përcaktimin e shkakut që prish agjërimin.

A mos vallë çdo gjë që hyn në bark, ose trup, ose që depërton në stomak, e prish agjërimin? Po vendi nga ku hyn, a mos vallë duhet të jetë një vend-hyrje i zakonit si goja dhe hunda, apo diçka e pazakontë si veshët, etj.? Po ajo që hyn duhet medoemos të jetë ushqyese si të ngrënit dhe të pirët, apo nuk është kusht dhe si rrjedhojë çdo gjë që hyn konsiderohet prishës i agjërimin? Mosmarrëveshjet lindin për shkak të saktësisë dhe dobësisë së disa haditheve, si dhe për shkak të saktësisë së analogjisë në shumë prej rasteve. Të gjitha këto janë arsye për këndvështrimet e ndryshme në shumë prej çështjeve. Po ashtu, zbulimet e mjekësisë moderne janë shkak për mosmarrëveshjet rreth asaj që besonin fukahatë për daljet e trupit tek njëra-tjetra, ose mospërfshirja e disa prej tyre, si daljet e hundës, syrit dhe të dy jashtëqitjeve në stomak. Dijetarët kanë dy këndvështrime rreth gjërave që

prishin agjërimin: Ku disa prej tyre i ngushtojnë dhe disa të tjerë i zgjerojnë ato.

86- Gëlltitja e një sasive tepër të vogël e ushqimit, nëse e bën qëllimisht, e prish agjërimin dhe nëse nuk e bën qëllimisht, agjërimi i tij është i saktë. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse është diçka që nuk mund të mbrohesh prej saj.

87- Gëlltitja e mbetjeve të ushqimit mes dhëmbëve, është një çështje e njëjtë me çështjen e kaluar.

88- Kryerja e marrëdhënieve bashkëshortore gjatë ditës, e prish agjërimin, sipas mendimit unanimit të dijetarëve, del apo nuk del sperma. Argumentet për këtë çështje janë tepër të njohura. Nën këtë temë janë disa çështje:

89- Shpagimi i marrëdhënieve intime është lirimi i një robi. Nëse nuk gjen, atëherë të agjërojë dy muaj rresht dhe nëse nuk mundet, atëherë të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Ky shpagim bëhet korrektësisht sipas radhitjes që përmendëm dhe jo sipas qejfit. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, duke u argumentuar me hadithin e Ebu Hurejres (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i cili thotë: "Njëherë ishim ulur tek profeti (ﷺ) dhe atij i erdhi një burrë dhe i tha: O i Dërguari i Allahut! U shkatërrova. Ai i tha: "Çfarë ke?" Ai tha: Bëra marrëdhënie intime me bashkëshorten time kur isha agjëruar. I Dërguari i Allahut (ﷺ) i tha: "A mos vallë ke ndonjë rob që ta lirosësh?" Ai tha: Jo. Ai i tha: "A mundesh të agjërosh dy muaj rresht?" I tha: Jo. Ai i tha: "A ke mundësi të ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?" Tha: Jo. Profeti (ﷺ) qëndroi pak dhe ndërkohë që ishim ende aty, profetit (ﷺ) i sollën një sasi burmash arabe dhe ai tha: "Ku është pyetësi?" Ai tha: Unë. Ai i tha: "Merri këto dhe jepi sadaka." Ai

tha: A mos vallë ka ndonjë më të varfër se unë, o i Dërguari i Allahut? Betohem për Allahun se nuk ka ndonjë më të varfër se unë dhe familja ime mes dy lagjeve të saj (Medines). Profeti (ﷺ) qeshi, aq sa u shfaqën dhëmbët e tij, pastaj i tha: “Ushqe familjen tënde.”¹⁷

90- Nëse është i pamundur lirimi i robërve, siç është realiteti në ditët e sotme, atëherë transferohet tek agjërimi dhe nuk bëhet llogaritja e çmimit të robit e të jepet në vlerë monetare, sipas mendimit më të saktë, që është edhe përzgjedhja e katër imamëve, sepse hadithi është tepër i qartë në faktin se transferimi ndodh kur nuk gjendet ajo, aq më tepër që transferimi tek vlera monetare është në kundërshtim me tekstin sheriatik.

91- Kush e prish agjërimin gjatë agjërimit të dy muajve rresht, për shkak të sëmundjes, ose udhëtimit, ose menstruacioneve, ose lehonisë, ose paditurisë, ose harresës, të gjitha këto shkaqe nuk e dëmtojnë aspak atë. Ky është edhe mendimi i disa fukahave.

Shënim: Kush e ka për detyrë të agjërojë dy muaj rresht, por që nuk mundet t'i agjëroj rresht pa ndërprerje dhe mundet t'i agjëroj të shpërndara, ai e ka për detyrë t'i agjëroj dhe ta prishë agjërimin kur i vjen shkak, siç e përmendëm edhe më lart.

92- Kush nuk mundet të agjërojë për shkak të sëmundjes ose të pleqërisë, ai ushqen gjashtëdhjetë të varfër, meshkuj ose femra, edhe nëse janë fëmijë që e hanë ushqimin, duke i ushqyer të gjithë një herë e mirë, ose duke ua shpërndarë në disa ditë, derisa të plotësohet shifra e

17 E transmeton Buhariu (1936) dhe Muslimi (1111).

gjashtëdhjetë të varfërve. E nuk lejohet t'ia japë një personi të vetëm një herë e mirë në një ditë qoftë, apo në gjashtëdhjetë ditë. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, për shkak të tekstit të qartë profetik.

93- Masa e ushqimit është një çështje që ka larmishmëri mendimesh dhe shkak i kësaj larmishmërie të mendimeve, është për shkak të transmetimeve të shumta që kanë ardhur rreth masës së ushqimit, mendimet e ndryshme rreth saktësisë ose jo të haditheve dhe saktësisë së analogjisë mbi shpagimet e tjera. Disa thonë se masa e ushqimit është pesëmbëdhjetë sa'ë, që është edhe mendimi i disa fukahave dhe sepse profeti (ﷺ) e urdhëroi për këtë sasi atë që kreu marrëdhënie intime¹⁸. Çdo të varfëri i takon gjysëm sa'e dhe jo më pak, ku një sa'ë llogaritet afërsisht me tre kilogramë. Disa të tjerë thonë se duhet të jetë një ushqim i bollshëm që e ngop njeriun, që është edhe mendimi i disa fukahave, për shkak të dobësisë së argumenteve përcaktuese dhe larmishmërisë së tyre. Në këtë çështje thuajse janë të pranueshme të dyja mendimet, por mendimi i parë është më i sigurtë dhe ushqimi të jetë prej ushqimeve që përdorin njerëzit e atij vendi.

94- Ai mund t'i gostisi ata me drekë ose me darkë, por shifra e tyre duhet të korrespondojë me numrin e të varfërve. Ky është mendimi i disa prej të parëve dhe fukahave. Po ushqimi, a vallë duhet të jetë në një masë të caktuar, apo aq sa ata të ngopen? Kjo çështje është e njëjtë me çështjen e kaluar.

18 E transmeton Ebu Daudi (2393) dhe e saktësoi Albanij. Ndërsa Ibën El-Kattani e konsideroi të dobët në veprën "El-Uehmu uel-ljham" (2/122), "Fet'hul-Barij" (4/169).

Shënim: Shpenzimi i ushqimit dhe sponsorizimi i tij për atë që nuk ka mundësi ekonomike të japë, bëhet pas marrjes së lejes nga ana e tij, siç e përmendëm edhe më lart.

Sqarim: Arsyet që lejojnë transferimin nga agjërimi tek ushqimi, janë diçka mes Allahut dhe robit dhe çdokush e njeh më mirë veten e tij se sa e njohin të tjerët atë, por kurrsesi nuk lejohet transferimi tek ushqimi për shkak të justifikimeve, vështirësisë, lehtësisë dhe pandehjeve.

95- Kush nuk mundet ta japë shpagimin, ai nuk bie kurrë prej tij dhe do të mbetet në qafën e tij dhe duhet ta japë menjëherë atë shpagim kur t'i jepet mundësia. Nëse vdes dhe nuk iu dha mundësia të shpaguajë, ai s'ka asgjë, por nëse ka lënë trashëgimtarë, ata e kanë për detyrë të japin shpagimin e tij. Ky është edhe mendimi i shumicës së fukahave.

96- Po bashkëshortja, a vallë duhet ta kryejë edhe ajo shpagimin për kryerjen e marrëdhënieve intime? Këtu janë dy raste:

- *Rasti i parë:* Nëse ajo ka qenë e detyruar, nuk ka shpagim për të, sipas mendimit unanimit.
- *Rasti i dytë:* Nëse e bëri me pëlqimin e saj, e ka për detyrë të kryejë shpagimin, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse origjina është se edhe gratë janë të përfshira në gjykim, derisa të vij një argument që i dallon ato nga burrat, argument i cili në këtë rast nuk ekziston.

97- A e zëvendëson ditën në të cilën kreu marrëdhënie intime?

Po, e ka detyrë ta zëvendësojë atë. Ky është mendimi i katër imamëve, sepse i Dërguari (ﷺ) e urdhëroi atë që kreu marrëdhënie intime për zëvendësim të asaj dite: *“Dhe zëvendëso një ditë në vend të saj.”*¹⁹ Si dhe duke e krahasuar me atë që vjellë qëllimisht, i cili duhet ta zëvendësojë atë ditë, sepse origjina është zëvendësimi i asaj dite dhe nuk ka ndonjë gjë që mund ta rrëzojë atë. Ngaqë e drejta bie duke e vepruar ose duke e zëvendësuar, aq më tepër që edhe argumentet faktojnë për këtë mendim.

98- Kush bën imoralitet (Allahu na ruajtë!), e ka për detyrë të shpaguej, sipas mendimit të shumicës së fukahave, njësoj si martesë e saktë dhe nuk ka asnjë dallim, sepse është cënuar shenjtëria e muajit me diçka të ndaluar, madje shpagimi për të është edhe më i detyrueshëm se për të tjerët.

99- Kush e prish qëllimisht agjërimin që të kryej marrëdhënie intime, ai është ngarkuar me gjynah dhe e ka detyrë të shpaguej. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse të thuhet që nuk e ka për detyrë shpagimin, është një lloj rrengë dhe Sheriati nuk ka ardhur me këto lloj rrengash.

100- Kush ha duke harruar që është agjëruer dhe mendon se e ka prishur agjërimin, kështu që kryen edhe marrëdhënie intime, ndaj tij nuk ka shpagim. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse padituria e momentit është si padituria rreth gjykimit të një çështjeje, kështu që

¹⁹ E transmeton Ebu Daudi (2393) dhe Bejhëkiu (8057). Ibën Haxhari thotë: Ka origjinë. “Fet’hul-Barij (4/172), “El-Irshad” i El-Khalilij (1/344), “El-Ahkamul-Usta” (2/231) dhe “Tehdhijbus-Sunen” i Ibën El-kajjim (1/447).

ai e ka detyrë vetëm ta zëvendësojë agjërimin e asaj dite me një ditë tjetër.

101- Përsëritja e marrëdhënieve intime ka disa raste:

a) Nëse e përsërit marrëdhënien në një ditë të vetme dhe nuk ka shpague për të parën, ka vetëm një shpagim, sipas mendimit unanim të dijetarëve.

b) Nëse e përsërit marrëdhënien në një ditë të vetme dhe shpagoi për të parën, ka vetëm një shpagim. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse kur kreu marrëdhëniet e tjera nuk ishte në agjërim të saktë.

c) Nëse e përsërit marrëdhënien në dy ditë dhe shpague për ditën e parë, ai shpague edhe për të dytën. Për këtë çështje nuk ka asnjë mosmarrëveshje.

d) Nëse e përsërit marrëdhënien në ditë të ndryshme dhe nuk shpague, ka disa mendime të dijetarëve dhe mendimi më i saktë është se shpagimet do të jenë të ndryshme, ashtu sikurse edhe ditët janë të ndryshme. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse çdo ditë është një adhurim i veçantë. Nëse dikush thotë: Po në ndodhinë e atij që kreu marrëdhënie dhe i Dërguari (ﷺ) nuk e pyeti atë: *“Sa ditë kreve marrëdhënie? Përgjigjia ndaj kësaj pyetje është të themi se ka ardhur një transmetim që e kufizon këtë, që është: Ai tha: Bëra marrëdhënie me bashkëshorten time në një ditë nga muaji i Ramazanit. Ai i tha: “Liro një rob.”*²⁰

²⁰ E transmeton Bejhekiu në “El-Kubra” (8048) dhe Darakutnij (2303), i cili edhe e saktësoi këtë transmetim.

102- Po nxjerrja e organit, a merr gjykimin e kryerjes së marrëdhënieve?

Me nxjerrjen e organit nënkuptohet fakti kur burri e nxjerr menjëherë organin e tij nga kryerja e marrëdhënies, sapo dëgjon muezinin të thërrasë ezanin, ose kur hyn koha e namazit të sabahut.

Gjykimi i tij: Ky gjest nuk merr gjykimin e kryerjes së marrëdhënieve dhe si rrjedhim agjërimi është i saktë, duke iu referuar mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që njëkohësisht është edhe mendimi i Ibën Umerit dhe i shumicës së fukahave, sepse ai e ndërpreu menjëherë veprimin dhe nuk vazhdoi më kur hyri koha.

103- Nëse burri kryen marrëdhënie me gruan e tij para namazit të sabahut dhe vazhdon të kryejë marrëdhënie duke menduar se nuk ka hyrë ende koha e namazit të sabahut, por që më pas u sigurua se kishte hyrë, dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) në lidhje me këtë çështje kanë disa mendime:

Mendimi i parë: Ai as nuk duhet ta zëvendësojë atë ditë dhe as nuk duhet të shpaguaj për të. Ky është mendimi i disa prej të parëve tanë, si Sejd ibën Xhubejri, Muxhahidi, Haseni dhe Is'haku.

Mendimi i dytë: Agjërimi është i pavlefshëm dhe ai nuk duhet të shpaguaj për të, që është edhe mendimi i disa fukahave.

Mendimi i tretë: Ai duhet ta zëvendësojë atë ditë dhe duhet të japë shpagim për të, që është edhe mendimi i disa fukahave.

Mendimi më i saktë, është mendimi i parë, sepse gjykimi i të paditurit është i njëjtë me atë që harron.

104- Kush kryen marrëdhënie natën dhe e nxjerr organin, por sperma i del pas sabahut, agjërimi i tij është i saktë, unanimisht, sepse thjesht dalja e spermës nuk e prish agjërimin.

105- Kush kryen marrëdhënie intime natën dhe zbardh mëngjesi por ai vazhdon të kryejë marrëdhënie, e ka prishur agjërimin dhe duhet ta zëvendësojë atë ditë dhe duhet të japë shpagim për të. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse kreu marrëdhënie gjatë kohës së agjërimit.

106- Nëse udhëtari mbërrin në destinacionin e tij dhe nëse gruaja me menstruacione pastrohet, ata nuk e kanë detyrë të përmbahen nga gjërat që e prishin agjërimin në pjesën e mbetur të ditës, sipas mendimit më të saktë. Madje nëse kryejnë marrëdhënie intime nuk ka shpagim ndaj tyre. Ky është mendimi i shumicës së fukahave.

107- Kush kryen marrëdhënie intime dhe lahet pas sabahut, agjërimi i tij është i saktë. Argument për këtë është hadithi i Umu Selemes (Allahu qoftë i kënaqur me të dyjal), se profeti (ﷺ) “*zbardhej xhunub në sabah pasi kishte kryer marrëdhënie, pastaj lahej dhe vazhdonte agjërimin.*”²¹ Dhe në një tjetër transmetim ka ardhur: “*Dhe nuk e zëvendësonte.*”

22

21 E transmeton Buhariu (1931) dhe Muslimi (1109).

22 E transmeton Muslimi (1109).

108- Nxjerrja e spermës për shkak të kontrollit mjekësor, ka dy raste:

Rasti i parë: Nëse bëhet nëpërmjet ndërhyrjes kururgjikale, nuk e prish agjërimin, sepse nuk është masturbim dhe nuk ka as lëvizje dhe as kënaqësi.

Rasti i dytë: Nëse bëhet nëpërmjet aparatit të derdhjes, e prish agjërimin, sepse është i ngjashëm me masturbimin dhe sepse ka edhe lëvizje edhe kënaqësi.

109- Injektimi i spermës tek gruaja për kryerjen e analizave dhe kurim, nuk e prish agjërimin, sepse nuk është marrëdhënie intime dhe as diçka e ngjashme me të.

110- Përdorimi i misvakut është i ligjshëm, para meridianit unanimisht dhe pas meridianit. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, duke u bazuar në faktin se argumentet e misvakut, kanë ardhur të pakufizuara dhe argumentet që ndalojnë përdorimin e tij në ato kohë, nuk janë të sakta.²³

111- Gëlltitja e mbetjeve të misvakut nuk e prish agjërimin, sipas mendimit më të saktë, njësoj si çështja e kaluar.

112- Është e urryer prova e shijes së ushqimit (pa e gëlltitur) pa patur nevojë dhe lejohet prova e shijes së ushqimit kur është e nevojshme. Ky është mendimi i shumicës së fukahave.

113- Puthjet dhe përqaftimet ndahen në tre lloje:

- a) Pa epsh, janë unanimesht të lejuara.
- b) Me epsh, të çojnë në zbritjen e ndaluar (të spermës), sipas mendimit unanimit.
- c) Me epsh të shoqëruar nga siguria e mos zbritjes (së spermës), janë të lejuara. Ky është mendimi i disa fukahave dhe njëkohësisht është edhe veprimi i profetit (ﷺ).²⁴

114- Kushtet e prishjes së agjërimit:

- a) Dituria rreth gjërave që e prishin agjërimitin, e kundërta e së cilës është padituria. Ky është mendimi i shumicës së fukahave.
- b) Kujtesa, e kundërta e së cilës është harresa, sipas mendimit të shumicës së fukahave.
- c) Pëlqimi, e kundërta e të cilit është detyrimi dhe imponimi, që është mendimi i disa fukahave.

Kush vepron një nga gjërat që e prishin agjërimitin: Duke patur dije, duke patur kujtesë dhe me pëlqimin e vet, ai e ka prishur agjërimitin e tij. Ndërsa kush vepron një nga gjërat që e prishin agjërimitin duke harruar, duke mos e ditur, ose gabimisht, ai nuk e prish agjërimitin, duke u argumentuar me argumentet e përgjithshme, me të cilat justifikohet i padituri, ai që harron, ai që gabon dhe ai që detyrohet.

115- Ai që e prish agjërimitin qëllimisht pa kryer marrëdhënie intime, nuk e ka për detyrë shpagimin e ashpër, duke iu referuar mendimit më të saktë mes dy mendimeve

24 E transmeton Muslimi (1106).

të dijetarëve, që është edhe mendimi i disa fukahave, sepse ai argument ka ardhur vetëm për marrëdhëniet intime.

116- Dituria rreth ndalimit të kryerjes së marrëdhënies intime dhe padituria rreth shpagimit nuk e zhvlerësojnë gjykimin e shpagimit. Për këtë nuk ka mosmarrëveshje, siç argumenton edhe ndodhia e atij që kreu marrëdhënie (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

117- Po mëkatet, a e prishin agjërimin? Dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) kanë disa mendime rreth kësaj çështje:

Mendimi i parë: Nuk e prishin atë, por mangësojnë shpërblimin e tij. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk ka argument për prishjen e tij.

Mendimi i dytë: E prishin atë. Ky është mendimi i Auzait dhe Nakhajit. Vetëm se mendimi më i saktë, është mendimi i parë. Një nga të parët thoshte: “Nëse përgojimi do ta prishte agjërimin, ne nuk do kishim agjërim.” O Allah! Na i mbro agjërimin tonë dhe pjesët e trupit tonë.

118- Kush ha duke harruar dhe mendon se e ka prishur agjërimin dhe pastaj ha përsëri qëllimisht, agjërimi i tij është i pavlefshëm. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse ngrënia e dytë e tij ishte e qëllimshme.

119- A i lejohet punëtorit që punon në punë të rënda, ta prishë agjërimin, se frikësohet se mos dëmtohet në shëndetin e tij?

Nëse mundet të marrë lejen e zakonshme, kjo është më e mira për të, por nëse e ka të pamundur marrjen e lejes, dijetarët kanë thënë se e ka të lejueshme prishjen e agjërimin, duke u argumentuar me argumentet e përgjithshme

që faktojnë për largimin e mundimit dhe barrës së rëndë. Si dhe për faktin që vështirësia sjell lehtësimin.

120- Është detyrë të priset agjërimi për shkak të shpëtimit të jetës së njeriut, nëse nuk mund të shpëtohet vetëm se duke e prishur agjërimin, sepse ajo gjë pa të cilën nuk realizohet detyra vetëm se me të, ajo është detyrë. Si shembulli i punonjësve që shërbejnë në operacionet e shpëtimit të aksidenteve, si mjekët, etj.

121- Ndërprerja e nijetit (qëllimit) të agjërimin në agjërimin e obligueshëm, e prish agjërimin, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse ai në një pjesë të ditës nuk e kishte nijetin e agjërimin.

122- Kush e bën nijet ndërprerjen e agjërimin nafle dhe nuk e ka prishur agjërimin, e më pas kthehet prapë dhe synon vazhdimin e agjërimin, agjërimi i tij është i saktë, sepse në agjërimin nafle nuk është kusht nijeti i agjërimin gjatë gjithë ditës.

123- Kush është në mëdyshje rreth prishjes së agjërimin dhe nuk e ka prishur atë, agjërimi i tij është i saktë, duke qëndruar në nijetin fillestar, që është agjërimi.

124- Kush e bën nijet të veproj një nga gjërat që prishin agjërimin, si të ngrënit dhe të pirët, por që nuk e bën një gjë të tillë, agjërimi i tij është i saktë, sepse nuk e veproi atë gjë me të cilën priset agjërimi. Mirëpo atij nuk i lejohet të dëshiroj të veproj një gjë të tillë pa patur një arsye fetare, sepse konsiderohet një dëshirë për të vepruar një mëkat.

125- Kush shikon dikë që po ha ose po pi duke harruar , le ta kujtojë menjëherë atë, sepse ky gjest konsiderohet një bashkëpunim në mirësi dhe devotshmëri.

126- Gruas i lejohet të përdorë pilulat që pengojnë zbritjen e menstruacioneve që të agjërojë, por më e mira është të mos i përdori këto pilula që pengojnë menstruacionet nëse ato i shkaktojnë çrregullime dhe rrjedhje të gjakut dhe prerje të tij. Ndërsa ajo është e arsyetuar dhe ka shpërblim. Asaj i lejohet të përmendë Zotin e saj, të lutet dhe të lexoj Kur'an pa e prekur atë, si p.sh. ta lexoj atë nëpërmjet aparatit celular etj.







Së katërti:

Agjërimi në udhëtim



Së katërti: Agjërimi në udhëtim

127- Mos agjërimi në udhëtim ka disa raste:

- *I pari:* Në momentin që hyn Ramazani, ai është në udhëtim e sipër, ai në këtë rast ka të drejtë të mos agjëroj. Në këtë çështje nuk ka asnjë mosmarrëveshje.
- *I dyti:* Të udhëtoj gjatë gjithë natës dhe ta vazhdoj udhëtimin deri ditën e nesërme. Ai edhe në këtë rast ka të drejtë të mos agjëroj, duke iu referuar mendimit kryesor të dijetarëve në përgjithësi.
- *I treti:* Të dalë nga vendi i tij si udhëtar dhe pastaj të bëj nijet të agjëroj në një nga ditët e udhëtimit të tij, pastaj dëshiron ta prishë agjërimin, i lejohet edhe ta prishë atë. Ky është mendimi i disa fukahave, duke u argumentuar me hadithin e Xhabir ibën Abdil-lahit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), se i Dërguari i Allahut (ﷺ) doli në vitin e çlirimit të Mekës, për në Mekë në muajin e Ramazanit dhe agjëroi derisa mbërriti në “Kiraul-Gumejm”, edhe njerëzit agjëruan bashkë me të. Më pas ai kërkoi një enë me ujë të cilën e ngriti lart aq sa e panë të gjithë njerëzit dhe piu ujë. Më pas atij i thanë se disa njerëz kishin agjëruar dhe profeti (ﷺ) tha: “Ata janë kundërshtues, ata janë kundërshtues.”²⁵

25 E transmeton Muslimi (1114).

- *I katërti:* Të dalë nga vendi i tij para agimit të mëngjesit dhe e ka bërë nijet të agjërojë, por më pas gjatë udhëtimit dëshiron ta prishë agjërimin. Dijetarët kanë disa mendime rreth kësaj çështjeje dhe mendimi më i saktë është se i lejohet ta prishë agjërimin, që është edhe mendimi i disa fukahave, sepse është udhëtar dhe arsyetimi i udhëtarit është i pakufizuar, e bëri nijet të agjërojë kur ishte në vendin e tij apo kur ishte udhëtar dhe është njësoj si i sëmuri.
- *I pesti:* Të udhëtojë para agimit të mëngjesit dhe të mos e ketë bërë nijet të agjërojë, atij i lejohet ta prishë agjërimin, sepse nuk e bëri nijet të agjëronte.

128- Si është më mirë për udhëtarin, të agjëroj, apo të mos agjëroj? Dijetarët (Allahu i mëshiroftël!) kanë disa mendime rreth kësaj çështjeje:

Mendimi i parë: Është më mirë të mos agjërojë. Ky është mendimi i Ibën El-Musejib, Muxhahidit dhe disa fukahave.

Mendimi i dytë: Është më mirë të agjërojë, që është edhe mendimi i shumicës së fukahave.

Mendimi i tretë: Të veproj atë që është më e lehtë për të, sipas mendimit të disa fukahave.

Mendimi i katërt: Është i lirë të veproj atë që dëshiron, mendim i cili është transmetuar nga disa prej sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Mendimi më i saktë, është mendimi i parë dhe argument për të është hadithi i Hamzës ibën Amër El-Eslemij (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili tha: O i Dërguari i Allahut! Unë e shoh veten time të fortë dhe

mundem të agjëroj edhe në udhëtim, a mos vallë ngarkohem me gjynah? I Dërguari i Allahut (ﷺ) i tha: “Ajo është leje nga Allahu, kush e merr atë, ka bërë mirë dhe kush do të agjërojë, nuk ka gjynah për të.”²⁶

129- Më e mira për agjëruesin është që të agjërojë edhe kur është në udhëtim ditët e Ashuras dhe Arafatit, sipas mendimit të disa fukahave, sepse ato janë ditë që nuk zëvendësohen me ditë të tjera. Mendim i cili ka ardhur edhe nga Ibën Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!)²⁷ dhe Zuhrij.²⁸

130- Udhëtarit i lejohet ta prishë agjërimin në të gjitha llojet e udhëtimit pa përjashtim, edhe nëse është udhëtim i ndaluar, ose udhëtim për shkak të daljes për gjah, për piknik, etj. Ky është mendimi i disa fukahave, sepse ai konsiderohet udhëtar dhe i lejohen të gjitha lehtësirat e udhëtimit.

131- Drejtuesit dhe shoferët e trenave, kamionëve, avionëve, anijeve, si dhe marinarët, etj. janë dy lloje:

- *I pari:* Nëse kanë një vendbanim tek i cili strehoen, atyre u lejohet ta prishin agjërimin kur janë në udhëtim.
- *I dyti:* Nëse nuk kanë një vendbanim tek i cili strehoen, familja e tyre është gjithnjë me ta dhe në këto mjete udhëtimi kanë gjithçka që u nevojitet, atëherë ata nuk e shkurtojnë namazin dhe nuk e prishin agjërimin, sepse nuk janë udhëtarë, ngaqë mjetet e tyre të udhëtimit janë atdheu i tyre dhe

26 E transmeton Muslimi (1121).

27 E transmeton Ibën Ebi Shejbe në “El-Musannaf (9338).

28 E transmeton Bejhëkiu në “Shuabul-Iman” 3518).

vendbanimi i tyre. Ky është mendimi i shumicës së fukahave.

132- Kush udhëton me qëllim që të prishë agjërimin, udhëtimi i tij është i ndaluar dhe nuk i lejohet të veprojë lehtësirat e udhëtimit. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse ai do të bëj rrenga dhe hile me dispozitat e Allahut. Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: I Dërguari i Allahut (ﷺ) thotë: “Mos bëni ato që bërën çifutët, që të lejoni të ndaluarat e Allahut me rrengën më të vogël.”²⁹

133- Nëse kryen marrëdhënie intime kur ishte në vendin e tij dhe më pas udhëton, ai e ka detyrë shpagimin. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse ai në kohën që kreu marrëdhënien ishte në vendin e tij dhe kjo nuk lejohet.

134- Nëse udhëtari e bën nijet të agjërojë dhe hyn në vendin e tij, atij nuk i lejohet ta prishë agjërimin. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse lehtësirat e udhëtimit u ndërprejnë.

135- Kush udhëton dhe e di mirë se ka për t’u kthyer në vendin e tij gjatë ditës, atij i lejohet ta prishë agjërimin. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse është udhëtar.

136- Kush hipën ditën në avion dhe dëshiron të agjërojë, të mos e prishë agjërimin derisa të humbasë dielli në zonën ku është ai. Nëse hipën në avion vetëm disa minuta para perëndimit të diellit dhe dita vazhdon ende me të, të mos e çeli iftarin derisa të perëndoj dielli.

²⁹ “Xhuz’u Ibtalul-Hijeli” i Ibën Battës (fq. 46) dhe Ibën Kethiri e konsideroi të mirë zinxhirin e tij të transmetimit. Shiko Tefsirin e tij (3/493).

137- Kush kalon në qiellin e një vendi, banorët e të cilit e kanë çelur iftarin, mirëpo ai vetë e shikon diellin aty ku është, të mos e prishë agjërimin por ta vazhdojë atë dhe ta çeli iftarin kur të zbresë në vendin ku do të mbërrijë dhe konstaton që ka përfunduar dielli. Argument për këtë është fjala e të Dërguarit të Allahut (ﷺ): “Kur të vij nata nga këtu, kur të iki dita nga këtu dhe të përëndo dielli, atëherë e çel iftarin agjëruesi.”³⁰

Sqarim: Kush udhëton gjatë ditës drejt lindjes, atij do t'i shkurtohet dita. Ndërsa kush udhëton drejt perëndimit, do t'i zgjatet dita. Prandaj, referencë për të është vendi në të cilin gjendet udhëtari në kohën e agimit të mëngjesit dhe në kohën e perëndimit të diellit, si do që të ndodhë me ditën, u shkurtua apo u zgjat.

138- Kush udhëton me avion dhe e ka të sigurt rezervimin, ndërsa aeroporti është jashtë rrethinave të vendbanimit të tij dhe e prishi agjërimin pasi doli nga vendi i tij, e më pas avioni u vonua ose ndodhi diçka e papritur që e pengoi nga udhëtimi në atë ditë, prishja e agjërimit të tij është e saktë dhe ai nuk duhet ta plotësojë agjërimin e asaj dite, sepse veprimi i tij ishte në përputhje me Sheriatin dhe ai vetëm se duhet ta zëvendësojë agjërimin e asaj dite me një ditë tjetër.

139- Udhëtari që do ta prishë agjërimin, të mos e prishë atë derisa të lë pas vendbanimet e vendit të tij. Ibën El-Mundhiri, Ibën Abdul-Berri, En-Neueuiju dhe Ibën Kudameh kanë deklaruar Ixhma'in (unanimitetin) për këtë

30 E përmendëm më lart burimin e tij.

çështje. Ndërsa hadithi i Ebi Basras³¹ dhe Enesit³² që ka ardhur për prishjen e agjërimit para daljes nga vendbanimet e vendit ku jeton, janë të dobët dhe kanë debat.

140- Kush udhëton duke qenë agjërues, i lejohej të kryejë marrëdhënie intime, hëngri gjë para kësaj apo jo, e bëri nijet ta prishë agjërimit apo nuk e bëri nijet atë, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse i lejohej ta prishë agjërimit kur është udhëtar, e prishi agjërimit me marrëdhënie intime apo me diçka tjetër.

141- Kush udhëton drejt vendit të tij dhe e ka prishur agjërimit, ai nuk e ka detyrë të mbaj agjërimit në pjesën e mbetur të ditës (pasi të ketë mbërritur në vendin e tij), duke iu referuar mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që është edhe mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk ka argument për të dhe nuk ka asnjë dobi në të.

142- Kush udhëton në muajin e Ramazanit, nuk i lejohej të agjërojë diçka tjetër veç Ramazanit, as si zëvendësim, as si shpagim dhe as ndonjë agjërimit vullnetar. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse nëse nuk vjen lehtësia, ai duhet të agjëroj atë që e ka obligim të agjërojë në këtë kohë.

143- Ndryshimi i shikimit të hënës së re në fillim dhe në fund mes dy vendeve, ka shtatë raste:

31 E transmeton Ebu Daudi (1402) dhe heshti ndaj tij. Vetëm se në zinxhirin e tij të transmetimit është Kulejbi dhe Ubejdi, të cilët janë të dy të panjohur, siç ka thënë Ibën Khuzejmeh në Sahihun e tij (2040).

32 E transmeton Tirmidhiu (799) dhe e konsideroi hasen (të mirë), ndërsa Sheukanij e konsideroi të dobët në "Nejlul-Autar" (4/271). Po ashtu e përmendi edhe Hafidh Ibën Haxhari dhe heshti ndaj tij.

- *I pari:* Kush udhëton nga një vend në fund të muajit Sha'aban dhe njerëzit nuk agjëronin dhe më pas kur ai kthehet në vendin e tij njerëzit panë hënën e re dhe agjëruan, atëherë edhe ai e ka detyrë të agjërojë bashkë me ta.
- *I dyti:* Kush udhëton nga një vend para se të hyj muaji i festës dhe ai agjëroi bashkë me ta, pastaj u kthye në vendin e tij dhe ata po agjëronin, dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) kanë disa mendime rreth kësaj çështje:

Mendimi i parë: Të agjërojë bashkë me ta derisa ata të përfundojnë agjërimin, edhe nëse i kalon tridhjetë ditë. Ky është mendimi i disa fukahave.

Mendimi i dytë: Ta prishë agjërimin fshehtas nëse kalojnë tridhjetë ditë. Ky është mendimi i disa fukahave. Më afër të vërtetës, është fakti që e prish, siç do ta sqarojmë në vijim.

- *I treti:* Kush udhëton nga një vend në të cilin u pa hëna e re e Sheualit dhe vjen në vendin e tij ku nuk e kanë parë ende hënën e re dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth këtij rasti, njësoj si mosmarrëveshja në çështjen e kaluar.

Më afër të vërtetës, është fakti se nuk lejohet të agjërojë dhe ai duhet ta prishë agjërimin fshehtas, sepse farzi i muajit të agjërimit është njëzet e nëntë ose tridhjetë ditë dhe kjo shtesë nuk lejohet, sepse muaji i agjërimit përfundoi. Ndërsa po të themi se është agjërim nafle, atëherë si u bë nafilja farz?

Fjalës së profetit (ﷺ): “Agjërimi është ditën që ju agjëroni dhe Fitri është ditën që ju bëni Fitër, ndërsa Kurbani është ditën që ju

bëni Kurban.”³³, i përgjigjemi duke thënë, se nuk është hadith i saktë, por edhe nëse është i saktë, agjërimi është në ditën që agjërojnë njerëzit nëse është në përputhje me Sheriatin, sepse ky hadith është përmendur në vazhdën e normave të fillimit të muajit dhe mbarimit të tij. Ndërsa në rastin tonë këtu, muaji ka përfunduar për të, duke pasuar vendin që ai pason. Ngaqë ai nuk është si dikush që sheh hënën e re i vetëm, e pastaj i refuzohet dëshmia. Ai e kreu detyrën e tij dhe të shtosh diçka mbi atë që është detyrë, është njësoj si të ngarkosh veten me atë që nuk e ka ligjësuar Allahu.

Shkaku i mosmarrëveshjes në dy çështjet e kaluara, është në faktin se cili nga dy vendet merret si referencë për të, i pari apo i dyti?

- *I katërti:* Kush udhëton nga një vend ku banorët e tij janë agjërues dhe janë në fund të muajit të Ramazanit, ndërsa ai vetë shkon në vendin e tij, ku banorët e atjeshëm e panë hënën e re, atëherë ai duhet ta prishë agjërimin bashkë me ta, edhe pse agjërimi i tij është më pak se njëzet e nëntë ditë, ai ta prishë agjërimin dhe ta zëvendësojë agjërimin e asaj dite me një ditë tjetër.
- *I pesti:* Kush agjëron në një vend dhe e prish agjërimin bashkë me ta për shkak të festës, ndërkohë që agjëroi vetëm njëzet e nëntë ditë dhe më pas udhëton në vendin e tij, gjendja e tij sillet rreth këtyre pikave që vijojnë:

33 E transmeton Tirmidhiu (697) dhe tha: “Hasenun garijbun” dhe e saktësoi Albanij. Ndërsa Darakutnij e saktësoi prej fjalës së Aishes. Shiko “El-llel” (3893).

a) Që vendi i tij dhe vendi për ku udhëtoi të kenë agjëruar të dy bashkë njëzet e nëntë ditë, kështu që atij i mjaftojnë njëzet e nëntë ditë.

b) Që vendi në të cilin ai e prishi agjërimin dhe ku prezantoi festën bashkë me ta, të ketë agjëruar njëzet e nëntë ditë, ndërsa në vendin e tij agjëruan tridhjetë ditë, ka agjëruar ose jo me banorët e vendit të tij; atij i mjaftojnë vetëm njëzet e nëntë ditë që agjëroi në vendin ku ai e përfundoi agjërimin dhe festoi bashkë me ta.

c) Kur të dyja vendet së bashku kanë agjëruar tridhjetë ditë, por ai vetë agjëroi njëzet e nëntë ditë dhe e prishi agjërimin për shkak të festës në vendin drejt të cilit udhëtoi, në rastin kur banorët e vendit të tij e filluan agjërimin pas banorëve të vendit drejt të cilit ai udhëtoi. Disa bashkëkohës janë të mendimit se atij i mjaftojnë agjërimi i njëzet e nëntë ditëve; sepse muaji ose është njëzet e nëntë ditë, ose është tridhjetë ditë. Por më e sigurt është që ai ta zëvendësojë atë ditë, sepse të dyja vendet agjëruan nga tridhjetë ditë.

- *I gjashti:* Kush jeton në një vend ku banorët e tij filluan agjërimin dhe udhëton në ditën e parë në një tjetër vend ku banorët e tij nuk e kanë filluar ende agjërimin dhe ai vendoset aty, këtu kemi dy raste:

a) Nëse ai vendoset në vendin drejt të cilit udhëtoi, e arrin festën bashkë me ta dhe ka agjëruar njëzet e nëntë ditë, atij i mbetet të zëvendësojë vetëm ditën e parë.


b) Nëse vendoset në vendin drejt të cilit udhëtoi, arrin të festojë bashkë me ta dhe agjëroi tridhjetë ditë, mbetet në qafën e tij zëvendësimi i ditës së parë, a ta agjërojë vallë

dhe kështu i bie të agjëroj tridhjetë e një ditë, apo të mos e agjëroj atë, sepse muaji është tridhjetë ditë? Kjo çështje duhet parë me ëndje, por më e sigurt është që ta zëvendësoj atë.

- *I shtati:* Kush udhëton nga vendi i tij dhe e ka prishur agjërimin, ndërkohë që ata agjërojnë ditën e tridhjetë dhe shkon drejt një vendi tjetër ku banorët e tij festojnë Fitër Bajramin, ai duhet ta zëvendësoj agjërimin e asaj dite me një tjetër ditë.

144- A lejohet të bëhet dita e tridhjetë ditë zëvendësimi i një dite tjetër? Nuk lejohet që udhëtari dhe i sëmuri të agjërojnë diçka tjetër në muajin e Ramazanit, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse në muajin e Ramazanit duhet të agjërohet vetëm Ramazani dhe asgjë tjetër.







Së pesti:

**Agjërimi i zëvendësimit
dhe ai vullnetar**



Së pesti: Agjërimi i zëvendësimit dhe ai vullnetar

145- Është e pëlqyeshme që të shpejtohet zëvendësimi i ditëve të Ramazanit dhe më parësore është që të mos vonohen pa ndonjë arsye, sepse njeriu nuk e di se çfarë mund t'i ndodhë prej halleve të dynjasë.

146- Zëvendësimi i ditëve të Ramazanit të kaluar duhet të bëhet para se të vij Ramazani i ardhshëm, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) nuk e vonoi zëvendësimin nga kjo hapësirë dhe kjo është më e sigurtë.

147- Nuk është kusht që zëvendësimi të jetë i njëpasnjëshëm, prandaj ai mund të jetë me ndërprerje sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që njëkohësisht është edhe mendimi i Enesit dhe Ebu Hurejres (Allahu qoftë i kënaqur me ta!)³⁴, si dhe mendimi i katër imamëve. Argument për të është fjala e Allahut të Lartësuar: *“le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar.”*

148- Kush e vonon Ramazanin derisa hyn Ramazani tjetër, ka dy raste:

- *I pari:* Nëse e ka vonuar me shkak, atëherë t'i zëvendësoj ato ditë pa ushqim si shpërblim, sipas mendimit unanimit.

34 Tefsiri i Ibën Ebi Hatimit (1/306).

- *I Dyti:* Nëse i ka vonuar pa shkak, atëherë e ka detyrë t'i zëvendësojë ato ditë dhe të japë edhe ushqim si shpërblim për çdo ditë. Ky është mendimi i shumicës së fukahave dhe është edhe fetvaja e gjashtë prej sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!)³⁵ për ushqimin si shpërblim.

149- Shpagimi nuk përsëritet me përsëritjen e kalimit të më tepër se një Ramazani kur vonon zëvendësimin, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, që është edhe mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk ka argument për të.

Shënim: Normat e ushqimit si shpërblim në këtë rast, janë të njëjta me normat e ushqimit si shpërblim që përmendëm në çështjen e atij që nuk ka mundësi të agjëroj.

150- Kush e prish qëllimisht agjërimin, pa ndonjë arsye, ai duhet të pendohet dhe duhet ta zëvendësojë atë ditë me një ditë tjetër, sipas mendimit të katër imamëve.

151- Është e lejuar ta prishë agjërimin në ditën që zëvendëson prej Ramazanit kur ka shkak dhe nuk lejohet ta prishë atë pa shkak. Kjo është një çështje për të cilën nuk ka mosmarrëveshje, sepse zëvendësimi është po i njëjtë me atë që zëvendëson dhe njësoj si ky janë edhe agjërimet e tjera që janë detyrë, si p.sh. shpëtimet.

152- Kush e prish agjërimin në ditën që zëvendëson, e ka për detyrë të zëvendësojë po të njëjtën ditë dhe jo të zëvendësojë dy ditë, sipas mendimit më të saktë mes dy

35 *El-Istidhkar (3/366), Es-Sunenul-Kubra i Bejhekiut (8211) dhe Musannafi i Abdurrazzakut (7620).*

mendimeve të dijetarëve, që është edhe mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk ka argument.

153- Është e lejueshme të agjëroj nafle para se të zëvendësojë ditët e Ramazanit, sipas mendimit të shumicës së fukahave, sepse koha që ka në dispozicion është tepër e bollshme.

154- Agjërimi i ditëve të Teshriikut në muajin Dhil-Hixh-xheh (që janë datat 13, 14 dhe 15-të) kanë dy raste:

- *I pari:* Është e ligjshme që haxhiu që kryen haxh temetu'u dhe kiran, nëse nuk ka mundësi të therri kurban, duhet t'i agjërojë këto ditë.
- *I dyti:* Atij që nuk është në haxh farz ose nafle, nuk i lejohej t'i agjëroj këto ditë, sepse ka ardhur ndalesë për këtë.³⁶ Ky është mendimi i shumicës së fukahave.

155- Është e lejueshme që zëvendësimi i ditëve të Ramazanit të bëhet ditën e xhuma dhe të shtunë. Ky është mendimi i të katër imamëve, sepse nuk synohet veçimi i tyre me agjërim. Përsa i përket hadithit që e ndalon agjërimin e ditës së shtunë, ai është një hadith i dobët siç kemi për ta sqaruar më poshtë.

156- Kush vdes dhe ka ditë pa zëvendësuar nga Ramazani, ka disa raste:

- *I pari:* Nëse mos agjërimi ka qenë për shkak të sëmundjes së pashërueshme dhe ai nuk ka dhënë

36 E transmeton Buhariu (1997) dhe Ebu Daudi (2418).

ushqim si shpërblim, atëherë trashëgimtarët e tij le të jepin ushqim si shpërblim nga pasuria e tij nëse ka lënë pasuri si trashëgimi, ose ata vetë të japin ushqim si shpërblim duke sponsorizuar vetë.

- *I dyti:* Nëse ka qenë për shkak të ndonjë sëmundje të shërueshme dhe sëmundja i zgjati derisa ndërroi jetë dhe nuk pati mundësi të agjërojë, atëherë as ai dhe as trashëgimtarët e tij nuk janë të ngarkuar me asgjë. Ky është mendimi i katër imamëve, sepse ka arsye dhe nuk e vonoi zëvendësimin për shkak të pakujdesisë.
- *I treti:* Nëse i mbaron shkakun dhe e vonon zëvendësimin për shkak të përtacisë derisa ndërroi jetë, atëherë trashëgimtarët e tij duhet të japin ushqim si shpërblim nga pasuria e tij nëse ka lënë trashëgimi, ose të japin vullnetarisht ushqim si shpërblim. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse mbetet detyrë ndaj të vdekurit. Ndërsa disa dijetarë janë të mendimit se mund të agjërohet për të.

157- A u lejohet trashëgimtarëve të agjërojnë për të vdekurin e tyre në një ditë të vetme (disa prej tyre për ditë të ndryshme që ai i ka të prapambetura, por në njëjtën ditë), kur ai ka disa ditë të prapambetura? Këtu janë dy gjëra:

- *E para:* Nëse në atë agjërim nuk është kusht agjërimi i njëpasnjëshëm si zëvendësimi i ditëve të Ramazanit, atëherë trashëgimtarëve u lejohet të agjërojnë për të vdekurin e tyre në një ditë të

vetme ose në disa ditë, një person i vetëm ose disa persona.

- *E dyta:* Nëse ai agjërim duhet të jetë i njëpasnjëshëm dhe është kusht që të jetë i pandërprerë, si shpagimi i vrasjes dhe si shpagimi i marrëdhënies intime gjatë ditës së Ramazanit, atëherë ai që del vullnetar për të vdekurin duhet të jetë vetëm një person. Disa të tjerë thonë që mundet të agjërojnë edhe disa prej trashëgimtarëve dhe jo vetëm një. Të dyja këto mendime janë të disa prej fukahave dhe thuajse të dyja mendimet janë të forta.

158- Ndërhyrja në agjërim (duke agjëruar dy lloj agjërimesh me një nijet në të njëjtën ditë) ka disa raste:

a) Ndërhyrja mes detyrave si Ramazani dhe shpagimi. Kjo nuk lejohet unanimisht.

b) Ndërhyrja në agjërimin nafle dhe atë farz ka disa pika:

- *Pika e parë:* Kur njëra prej tyre rrjedhon nga tjetra, si agjërimi i gjashtë ditëve të Sheualit bashkë me zëvendësimin e ditëve të Ramazanit. Kjo nuk lejohet, sepse shpërblimi i gjashtë ditëve është i lidhur ngushtë me plotësimin e agjërimin të Ramazanit, siç do ta sqarojmë në vijim.
- *Pika e dytë:* Të jenë të ndara nga njëra-tjetra, më afër me këtë janë dy raste:

I pari: Nafilja e pakufizuar bashkë me farzin, si agjërimi i të hënës, të enjtes dhe dhjetë ditët e muajit Dhul-Hixh-xheh bashkë me zëvendësimin e ditëve të Ramazanit dhe

shpagimin. Ky lloj agjërimi është i saktë, duke e krahasuar me dy rekatet përshëndetëse të xhamisë bashkë me namazin farz. Ky është mendimi i katër imamëve.

I dyti: Një sunet i caktuar bashkë me farzin, si agjërimi i ditës së Arafatit dhe Ashuras bashkë me zëvendësimin e ditëve të Ramazanit dhe shpagimit. Më e sigurt është që të mos agjërohen të dyja bashkë me një nijet, sepse secila prej tyre është një adhurim specifik, si sunetet nafle me farzin, të cilat nuk mund të bashkojmë mes tyre. Ky është mendimi i katër imamëve, sepse origjina është mos ndërhyrja. Disa të tjerë thonë se quhet, sipas mendimit të disa fukahave.

c) Ndërhyrja mes agjërimin sunet ka disa raste:

I pari: Sunetet e pakufizuara, si agjërimi i dhjetë ditëve të Dhul-Hixh-xhes, tre ditëve të çdo muaji, të hënës dhe të enjtes. Ndërhyrja dhe shoqërimi mes tyre është i lejueshëm me një nijet si suneti i namazit të abdesit bashkë me dy rekatet përshëndetëse të xhamisë.

I dyti: Sunetet specifike, si agjërimi i gjashtë ditëve të Sheualit, Arafatit dhe Ashuras bashkë me ditën e hënë, të enjte dhe tre ditët nga çdo muaj, është e saktë që ato të shoqërohen bashkë, siç bashkohen dy rekatet përshëndetëse të xhamisë me sunetet ratibe dhe me namazin e paradites.

159- Është e pëlqyeshme që të agjërohen gjashtë ditët e Sheualit dhe mirësitë e tyre janë tepër të njohura dhe ai që ka ditë të mbetura nga Ramazani për të zëvendësuar, i agjëron këto gjashtë ditë pasi të ketë zëvendësuar ditët e mbetura, sipas mendimit të disa fukahave, sepse teksti që ka ardhur është i qartë dhe i dukshëm. Disa thonë se lejohet të

agjërohen këto gjashtë ditë edhe pa përfunduar zëvendësimin e Ramazanit, që është edhe mendimi i shumicës së fukahave. Por mendimi më i saktë është mendimi i parë, sepse fillimi me gjashtë ditët para agjërimit të Ramazanit, bie ndesh me kushtin që ka ardhur në hadith. Këto gjashtë ditë nuk mund të agjërohen në tjetër kohë veç muajit Sheual, sipas mendimit më të saktë mes dy mendimeve të dijetarëve, sepse është një sunet të cilit i iku koha ku mund të praktikohej. Ndërsa ai që është i arsyetuar në lënien e këtij agjërimi, shpresohet që të shpërblehet.

160- Agjërimi i ditës së Arafatit ka dy raste:

- *Rasti i parë:* Është e pëlqyeshme për atë që nuk është në haxh, sipas mendimit unanim dhe mirësia e kësaj dite është tepër e njohur.
- *Rasti i dytë:* Ai që është në haxh nuk e agjëron, ky është mendimi i shumicës së fukahave, me qëllim që të jetë sa më i lirshëm për adhurim, lutje dhe përmendjen e Allahut.

Më afër të vërtetës, është të thuhet se nëse dikush e ka të vështirë ta agjëroj këtë ditë dhe agjërimi i saj ka për ta dobësuar ndaj dhikrit dhe lutjeve, atëherë mos agjërimi është më i mirë përse i përket personit në fjalë, sepse mirësia e haxhit është më madhështore se mirësia e agjërimit të ditës së Arafatit. Nëse agjërimi nuk e dobëson, atëherë mundet të agjërojë, sipas mendimit të disa fukahave. Është transmetuar se e ka agjëruar Aishja, Usame ibën Zejdi, Zubejri, Uthman ibën Ebil-A'as (Allahu qoftë i kënaqur me ta!), Haseni, Katadja

dhe Ata'aja.³⁷ Ndërsa ndalesa që ka ardhur për mos agjërimin e saj, nuk është e saktë³⁸. Por edhe nëse është e saktë, themi se ndalesa nënkupton urrejtjen, ose është e ndaluar për atë që e ka të vështirë. Ngaqë nuk ka ardhur ndonjë transmetim nga i Dërguari i Allahut (ﷺ) që të ketë urdhëruar ndonjë haxhi që të mos agjëroj, si hadithi i Xhabir ibën Abdil-lahit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) se i Dërguari i Allahut (ﷺ) doli në vitin e çlirimit të Mekës në muajin e Ramazanit dhe agjëroi derisa mbërriti në “Kiraul-Gumejm”, edhe njerëzit agjëruan, pastaj ai kërkoi një enë me ujë dhe e ngriti lart aq sa e panë të gjithë njerëzit dhe pastaj piu prej saj. Më pas i thanë se disa prej të pranishmëve kishin agjëruar dhe ai tha: *“Ata janë kundërshtues, ata janë kundërshtues.”*³⁹ Në një transmetim tjetër ka ardhur: *“Disa prej të pranishmëve e kishin të vështirë të agjëronin.”* Me këtë transmetim dijetarët u argumentuan për ata që e kanë të vështirë të agjërojnë në udhëtim, ose ai i urdhëroi që ta prishnin agjërimin me qëllim që të ishin sa më të fuqishëm në përballjen me armikun, që është një përfitim dhe qëllim madhor, mirëpo ata (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) prapë së prapë nuk e bërën një gjë të tillë, derisa ai i motivoi dhe i detyroi për të.

161- Agjërimi i ditës së Ashuras është i pëlqyeshëm, edhe nëse korrespondon të jetë në ditën e shtunë, sipas mendimit të shumicës së fukahave. Ajo është dita e dhjetë e

37 E transmeton Maliku në “El-Muetta’” (1390), Musannaf i Ibën Ebi Shejbes (9219, 13395) dhe Fet’hul-Barij (4/238).

38 E transmeton Ebu Daudi (2440), El-Bedrul-munijr (5/749) dhe e konsideruan të dobët El-Ukejlj, Ibën Hazmi dhe En-Neueuij.

39 E transmeton Muslimi (1114).

muajit Muharram dhe është e pëlqyeshme që bashkë me të, të agjërohet edhe dita e nëntë. Mirësia e agjërimit të saj është tepër e njohur dhe agjërimi më i mirë pas Ranazanit është agjërimi në muajin e Allahut El-Muharram⁴⁰. Po ashtu është e pëlqyeshme që të agjërohet sa më shumë edhe në muajin Sha'aban, sepse profeti (ﷺ) e veproi një gjë të tillë.⁴¹ Ndërsa hadithi që ndalon agjërimin në ditën e shtunë, nuk është i saktë.⁴²

162- Nuk është i ligjshëm agjërimi në xhemat për shkak të largimit të fatkeqësive nga populli Islam, për shkak të ndonjë vendi, ose për shkak të ndonjë muslimani, etj. sepse nuk ka argument për këtë lloj agjërimi dhe se nuk është transmetuar nga sahabët dhe ata që ishin pas tyre një veprim i tillë, e siç dihet që origjina në adhurime është që të mos veprohen, derisa të vij argumenti.



40 E transmeton Muslimi (202).

41 E transmeton Bukhariu (1969) dhe Muslimi (1156).

42 Imam Maliku thotë që është gënjeshtër dhe e kanë konsideruar të dobët Nesajj, Zuhrij, Ibën El-Arabij, Ibën El-Mulekkin, etj.



Së gjashti:

Disa çështje rreth zekatit të Fitrit



Së gjashti: Disa çështje rreth zekatit të Fitrit

163- Sadakaja e Fitrit nxirret një sa'e⁴³ prej ushqimit që përdoret në atë vend ku jeton dhe jepet një ose dy ditë para namazit të festës, sipas mendimit të disa fukahave dhe kështu vepruan edhe sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).⁴⁴

164- Kush e vonon nxjerrjen e sadakasë së fitrit deri pas namazit të Fitër Bajramit, sepse kishte arsye, ai e jep atë dhe nuk ngarkohet me gjynah, por nëse nuk kishte arsye, atëherë e jep atë dhe është i ngarkuar me gjynah dhe duhet të pendohet. Ky është mendimi i shumicës së fukahave.

165- Kush e ka detyrë të japë sadakanë e fitrit dhe është në udhëtim e sipër, ai duhet ta japë atë në vendin në të cilin është vetë ai, sipas mendimit të disa fukahave, sepse sadakaja e fitrit pason njeriun kudo që të jetë. Mirëpo nëse ai ngarkon dikë që ta japë për të në vendin e tij, kjo është e lejuar dhe është përzgjedhja e disa fukahave.

166- Nëse dikush udhëton në një vend të caktuar, ai e jep sadakanë e fitrit edhe për familjarët e tij në vendin ku ndodhet ai vetë nëse ata nuk janë bashkë me të. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse ata janë në varësi të tij. Por është e lejuar që ata ta japin atë për veten e tyre në vendin e tyre, sipas mendimit të disa fukahave.

43 Njësi matëse në kohën e profetit (ﷺ), që është e barabartë me rreth tre kilogram.

44 E transmeton Bukhariu (1511).

Në mbyllje:

O Allah! Na kurorëzo me sukses që të agjërojmë dhe të falemi natën sa më mirë dhe mos na privo nga mirësitë e muajit të Ramazanit dhe bereqetit të tij. Mbroji zemrat tona nga çdo sëmundje dhe na e mbro agjërimin tonë, si dhe gjymtyrët dhe pjesët tona të trupit. Na udhëzo ne, pasardhësit tanë dhe bashkëshortet tona dhe na bëj të qëndrueshëm deri në vdekje. Na ruaj nga të këqijat dhe sprovat. Ndhimoi dhe triumfoji muslimanët kudo që ndodhen.

E shkruajti/ Fehd ibën Jahja El-Ammarij

Gjykatës në Gjykatën e Apelit

Vendi i sigurt (Mekë), më 25/03/1439.

Famary1@gmail.com

Përshtati në shqip, Bledar Ali



السلطنة العامة للبحوث والدراسات الإسلامية
إدارة العلاقات العامة بالمسجد الحرام
اللغة الألبانية



زَادَ الصَّلَامُ



فهل كنت بحبي العبداني

القاضي بمحكمة الاستئناف بمكة المكرمة